

LIGJI NR. 06/L-082**PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Përmes këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike.

2. Ky ligj është në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës, 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizik sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave, që shfuqizon Direktivën 95/46/EC (Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave të përgjithshme)“.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga organet publike dhe private. Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nëse përpunimi kryhet për qëllime krejtësisht personale.

2. Ky ligj zbatohet edhe në zyrat diplomatike dhe konsullore, si dhe në të gjitha përfaqësitë e tjera zyrtare të Republikës së Kosovës jashtë shtetit.

3. Ky ligj zbatohet edhe për kontrolluesit e të dhënave, të cilët nuk janë të themeluar në Republikën e Kosovës, por që për qëllime të përpunimit të të dhënave personale, përdorin pajisje automatike ose të tjera në Republikën e Kosovës, përveç nëse pajisjet e këtyra përdoren vetëm për qëllime të tranzitit nëpër territorin e Kosovës. Në këto rrethana, kontrolluesit duhet të caktojnë një përfaqësues të regjistruar në Kosovë.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **E dhënë personale** - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues *online*, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;

1.2. **Përpunim** - çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;

1.3. **Kufizimi i përpunimit** - shënjimi i të dhënave personale të ruajtura me synim kufizimin e përpunimit të tyre në të ardhmen;

1.4. **Klasifikim i të dhënave personale** – shënjimi i të dhënave personale për të treguar natyrën e tyre të ndjeshme. Për të dhënat e klasifikuara duhet përcaktuar kushtet, sipas të cilave, përdoruesi mund të bëjë përpunimin e tyre. Klasifikimi duhet të mbetet i bashkëngjitur me të dhënat personale të ndjeshme deri në fshirjen, asgjësimin, shkatërrimin ose anonimizimin e tyre;

1.5. **Profilizim** - çdo formë e përpunimit automatik të të dhënave personale që konsiston në përdorimin e të dhënave personale për të vlerësuar aspektet personale në lidhje me një person fizik, veçanërisht për të analizuar ose parashikuar aspekte në lidhje me mbarëvajtjen e personit në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, parapëlqimet personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet e tij;

1.6. **Pseudonimizim** - përpunimi i të dhënave personale në një mënyrë të tillë që të dhënat personale të mos vazhdojnë t'i referohen një subjekti të caktuar të të dhënave pa përdorimin e informacionit shtesë, me kusht që ky informacion shtesë të mbahet veçmas dhe t'u nënshtrohet masave teknike dhe organizative për të garantuar që të dhënat personale të mos i referohen një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm;

1.7. **Katalog i sistemit të dosjeve** - përshkrimi i hollësishëm i strukturës dhe përmbajtjes së sistemeve të dosjeve;

1.8. **Regjistër i sistemeve të dosjeve** – regjistër, i cili mundëson një pasqyrim të hollësishëm të sistemeve të dosjeve;

1.9. **Sistemi i dosjeve** – një komplet i strukturuar të dhënash personale që janë të qasshme në pajtim me kriteret specifike, të centralizuara, decentralizuara ose të shpërndara mbi bazë funksionale ose gjeografike;

1.10. **Kod lidhës** - numri personal i identifikimit ose çfarëdo numri tjetër i veçantë i identifikimit, i përcaktuar me ligj, lidhur me personin, i cili numër mund të përdoret për zbulimin ose rikthimin e të dhënave personale nga sistemet e dosjeve, në të cilat, gjithashtu përpunohet kodi lidhës;

1.11. **Kontrollues i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale;

1.12. **Pëlqim me shkrim i subjektit të të dhënave** – pëlqimi i dhënë sipas nën-paragrafit 1.11., të paragrafit 1. të këtij neni, ku përveç kësaj, subjekti i të dhënave duhet të vë nënshkrimin ose shenjë në pëlqimin me shkrim për përpunimin e të dhënave të tij ose saj;

1.13. **Pëlqim gojor ose pëlqim tjetër i përshtatshëm i subjektit të të dhënave** - pëlqimi nga nën-paragrafi 1.11., i dhënë gojarisht, me anë të mjeteve të telekomunikimit ose me ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm, përmes të cilit mund të konkludohet në mënyrë të qartë se subjekti i të dhënave e ka dhënë pëlqimin e tij ose saj;

1.14. **Përpunues i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik, nga sektori publik ose privat, i cili përpunon të dhëna personale për dhe në emër të kontrolluesit të të dhënave;

1.15. **Marrës i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat, të cilit i zbulohen të dhënat personale, qoftë palë e tretë ose jo. Megjithatë, autoritetet publike që mund të marrin të dhëna personale në kuadrin e një hetimi të veçantë, në pajtim me legjislacionin në fuqi, nuk konsiderohen si marrës. Përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet publike është në pajtim me rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave sipas qëllimeve të përpunimit;

1.16. **Palë e tretë** – çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që është i ndryshëm nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi, përpunuesi dhe personat që, sipas autorizimeve të drejtpërdrejta të kontrolluesit ose përpunuesit, janë autorizuar për të përpunuar të dhëna personale;

1.17. **Pëlqim i subjektit të të dhënave** - shprehje e lirë e vullnetit të dhënë lirisht, specifik, të informuar dhe të qartë të dëshirave të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklaram ose me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të;

1.18. **Shkelje e të dhënave personale** - çdo shkelje e masave të sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin e paautorizuar, aksidental ose të paligjshëm, ose qasjen në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe;

1.19. **Të dhëna gjenetike** - të dhënat personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të përfituara të një personi fizik që jep informacion unik në lidhje me fiziologjinë ose shëndetin e atij personi fizik dhe që rezulton, veçanërisht, nga një analizë e një mostre biologjike nga personi fizik në fjalë;

1.20. **Të dhëna biometrike** – të gjitha të dhënat personale që rezultojnë nga përpunimi specifik që kanë të bëjnë me karakteristikat fizike, psikologjike ose të sjelljes së një personi fizik që lejon ose konfirmon identifikimin unik të atij personi fizik si dhe imazhet pamore ose të dhënat daktiloskopike, psikologjike dhe të sjelljes, që i kanë të gjithë individët, por që janë të veçanta dhe të përhershme për secilin individ, nëse në veçanti mund të përdoren për identifikimin e një individi, siç janë: gjurmët e gishtërinjve, vijat papilare të gishtit, irida, retina, tiparet e fytyrës dhe ADN-ja;

1.21. **Të dhëna shëndetësore** - të dhënat personale në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të një personi fizik, duke përfshirë dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, që tregojnë informacion në lidhje me gjendjen e tij ose të saj shëndetësore;

1.22. **Përpunim ndërkufitar** - përpunim i të dhënave personale që kryhet në kuadër të aktiviteteve të autoriteteve në mes të shteteve;

1.23. **Privatësi** – respektimi i jetës private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës së telefonisë dhe e komunikimeve të tjera, në pajtim me ligjin e zbatueshëm;

1.24. **Bllokim** - ndalimi i përpunimit të mëtejshëm të të dhënave. Vendimi për bllokimin e të dhënave duhet të tregohet në mënyrë të saktë dhe duhet të mbetet i bashkëngjitur me të dhënat personale për aq kohë sa ekzistojnë arsyet për bllokim;

1.25. **Të dhëna personale të ndjeshme** - të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim

me ligjin. Karakteristikat biometrike, gjithashtu, konsiderohen si të dhëna personale të ndjeshme, nëse këto të fundit mundësojnë identifikimin e një subjekti të të dhënave në lidhje me cilëndo nga rrethanat e lartpërmendura në këtë nën-paragraf;

1.26. **Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia)** - agjenci e pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike;

1.27. **Komisioner** – organ i pavarur, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, në kuadër të Agjencisë, i cili është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të këtij ligji dhe të Ligjit për qasje në dokumente publike;

1.28. **Zyrtari për inspektim** – inspektor i Agjencisë, i cili kryen detyra inspektuese në përputhje me këtë ligj, me Ligjin përkatës për qasje në dokumente publike.

Neni 4

Parimet e përpunimit të të dhënave personale

1. **Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës** - të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.
2. **Parimi i kufizimit të qëllimit** – të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime. Përpunimi i mëtejshëm me qëllim të arkivimit për interes publik, qëllimit të hulumtimit shkencor ose historik, ose qëllimit statistikor, nuk konsiderohet që është në mospërputhje me qëllimin fillestar.
3. **Parimi i minimizimit të të dhënave** – të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar ose përpunuar më tutje.
4. **Parimi i saktësisë** – të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimin e përpunimit, të fshihen dhe të korrigjohen pa vonesë.
5. **Parimi i kufizimit të ruajtjes** – të dhënat personale mund të ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbyshjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.
6. **Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit** – të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.
7. **Parimi i llogaridhënies** – kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara me këtë nen.

KREU II

LEGJITIMITETI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Neni 5

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhtme:

- 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike;
- 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës;
- 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;
- 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë;
- 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit;
- 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë. Kjo nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike për përmbushjen e detyrave të tyre.

2. Nëse përpunimi për një qëllim tjetër nga ai për të cilin janë mbledhur të dhëna personale nuk bazohet në pëlqimin e subjektit të të dhënave ose në legjislacionin përkatës në fuqi, me qëllim që të konstatohet nëse përpunimi për një qëllim tjetër është në pajtim me qëllimin për të cilin janë mbledhur fillimisht të dhënat personale, ndërmjet të tjerash, merr parasysh:

- 2.1. çdo lidhje ndërmjet qëllimeve, për të cilat janë mbledhur të dhënat personale dhe qëllimet e përpunimit të mëtejshëm të synuar;
- 2.2. kontekstin në të cilin janë mbledhur të dhënat personale, veçanërisht në lidhje me raportin ndërmjet subjekteve të të dhënave dhe kontrolluesit;
- 2.3. natyrën e të dhënave personale, veçanërisht nëse përpunohen kategori të veçanta të të dhënave personale, në pajtim me nenin 8 të këtij ligji ose nëse përpunohen të dhënat personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale, në pajtim me nenin 9 të këtij ligji;
- 2.4. pasojat e mundshme të përpunimit të synuar të mëtejshëm për subjektet e të dhënave;
- 2.5. ekzistencën e garancive të përshtatshme, që mund të përfshijnë enkriptimin ose anonimizimin.

Neni 6 **Kushtet për pëlqim**

1. Nëse përpunimi bazohet në pëlqim, kontrolluesi duhet të jenë në gjendje të dëshmojë, që subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale.
2. Nëse pëlqimi i subjektit të të dhënave jepet në formë të deklaratës me shkrim, e cila ka të bëjë edhe me çështje të tjera, kërkesa për pëlqim duhet të paraqitet në një mënyrë që është qartësisht e dallueshme nga çështjet e tjera, në një formë të kuptueshme dhe lehtësisht të qasshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë.
3. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të tërheqë pëlqimin e tij në çdo kohë. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit, bazuar në pëlqim para tërheqjes dhe subjekti i të dhënave njoftohet për këtë. Tërheqja duhet të bëhet në të njëjtën mënyrë si edhe vetë dhënia e pëlqimit.
4. Gjatë vlerësimit, nëse pëlqimi është dhënë me vullnet të lirë, mbi të gjitha, duhet marrë parasysh nëse, përveç të tjerash, zbatimi i kontratës, përfshirë dispozitën e një shërbimi, kushtëzohet me pëlqimin e përpunimit të të dhënave personale që nuk është e domosdoshme për zbatimin e asaj kontrate.

Neni 7 **Kushtet që zbatohen për pëlqimin e fëmijës në lidhje me shërbimet e shoqërisë së informacionit**

1. Përpunimi i të dhënave personale të fëmijës është i ligjshëm aty ku aplikohet neni 5 nën-paragrafi 1.1. i këtij ligji në lidhje me ofrimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit drejtpërdrejt ndaj fëmijës, përpunimi i të dhënave personale të fëmijës është i ligjshëm kur fëmija është të paktën i moshës gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare. Kur fëmija është nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare, përpunimi i tillë është i ligjshëm vetëm nëse dhe për aq sa pëlqimi është dhënë ose autorizuar nga mbajtësi i përgjegjësishë prindërore mbi fëmijën.
2. Kontrolluesi bënë përpjekje të arsyeshme për të verifikuar në raste të tilla që pëlqimi të jetë dhënë ose autorizuar nga mbajtësi i përgjegjësishë prindërore mbi fëmijën, duke marrë parasysh teknologjinë në dispozicion.
3. Paragrafi 1. i këtij neni nuk ndikon në ligjin në fuqi që ka të bëjë me rregullat mbi vlefshmërinë, formimin ose efektin e një kontrate në lidhje me fëmijën.
4. Nëse përpunimi i të dhënave bëhet nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare deri në katëmbëdhjetë (14) vjeçare, kontrolluesi bënë përpjekje të vazhdueshme për të verifikuar se në këto raste pëlqimi për fëmijën është dhënë ose autorizuar nga prindi ose kujdestari i fëmijës, duke marrë në konsideratë teknologjinë në dispozicion.

Neni 8 **Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale**

1. Përpunimi i të dhënave personale që tregojnë origjinën racore ose etnike, bindjet politike, bindjet fetare ose filozofike, anëtarësinë në bashkimet profesionale, si dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike për qëllimet e identifikimit të një personi fizik në mënyrë unike, të dhënat në lidhje me shëndetin ose të dhënat në lidhje me jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi fizik është i ndaluar.
2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet nëse ekziston ndonjëra nga rrethanat e mëposhtme:

2.1. subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë për përpunimin e atyre të dhënave personale për një ose disa qëllime më specifike, përveç kur legjislacioni përkatës në fuqi përcakton që ndalimi i parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni nuk mund të anulohet nga subjekti i të dhënave;

2.2. përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve dhe ushtrimin e të drejtave specifike të kontrolluesit ose të subjektit të të dhënave në sferën e të drejtës së punësimit, sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale, në masën që është i autorizuar nga legjislacioni përkatës në fuqi ose një marrëveshje kolektive që garanton të drejtat themelore dhe interesat e subjektit të të dhënave;

2.3. përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër fizik, nëse subjekti i të dhënave nuk është fizikisht ose ligjërisht në gjendje të japë pëlqimin;

2.4. nëse ato përpunohen për qëllime të veprimtarive legjitime dhe me garanci të duhura nga institucionet, shoqatat, asociacionet, bashkësitë fetare, sindikatat ose organizatat e tjera jofitimprurëse me qëllime politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, por vetëm nëse përpunimi ka të bëjë me anëtarët e tyre ose subjektet e të dhënave që janë në kontakt të rregullt me ato e në lidhje me qëllimet e tilla dhe nëse ata nuk i zbulojnë të dhënat e tilla të tjerëve pa pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave;

2.5. nëse subjekti i të dhënave i ka bërë ato publike pa e kufizuar përdorimin e tyre në mënyrë të dëshmuar ose të qartë;

2.6. përpunimi është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore ose kurdoherë që gjykatat veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore;

2.7. përpunimi është i nevojshëm për interesin thelbësor publik mbi bazën e legjislacionit përkatës;

2.8. përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e mjekësisë parandaluese ose të punës, për vlerësimin e kapacitetit të punës së punonjësit, diagnozës mjekësore, dhënien e kujdesit shëndetësor social, trajtimin, menaxhimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor ose social dhe shërbimet mbi bazën e legjislacionit përkatës ose në pajtim me kontratat me një profesionist shëndetësor kur ato të dhëna procesohen nga ndonjë profesionist apo nën përgjegjësinë e tij që i nënshtrohet obligimit të fshehtësisë profesionale sipas legjislacionit përkatës, rregullave të themeluara nga organet kompetente nacionale apo nga ndonjë person tjetër që po ashtu i nënshtrohet obligimit të fshehtësisë;

2.9. përpunimi është i nevojshëm për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik, si mbrojtja ndaj kërcënimeve të rënda ndërkufitare për shëndetin ose garantimin e standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë së kujdesit shëndetësor dhe të produkteve mjekësore ose pajisjeve medicinale, mbi bazën e legjislacionit përkatës;

2.10. përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e arkivimit në interes publik, të kërkimeve shkencore, historike, statistikore.

3. Të dhënat personale të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni mund të përpunohen për qëllimet e përmendura në nën-paragrafin 2. të këtij neni, kur ato të dhëna përpunohen në mënyrë proporcionale me qëllimin e kërkuar, përpunimi i tyre e respekton thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe bëhet në pajtim me masat specifike për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave themelore të subjektit të të dhënave siç parashihet në këtë ligj, përfshirë aty ku është e nevojshme, fshehtësinë profesionale.

4. Kategoritë e veçanta të të dhënave personale ,duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar, përveç në rastet nga nën-paragrafi 2.5. i paragrafit 2. të këtij neni.

Neni 9

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale ose masat përkatëse të sigurisë, bazuar në nenin 5. paragrafin 1. të këtij ligji kryhet vetëm nën kontrollin e autoritetit zyrtar sipas ligjit përkatës. Çdo regjistër gjithëpërfshirës i dënimeve penale mbahet vetëm nën kontrollin e autoritetit zyrtar.

Neni 10

Përpunimi që nuk kërkon identifikim

1. Nëse qëllimet, për të cilat një kontrollues përpunon të dhëna personale nuk kërkon ose nuk vazhdon të kërkojë identifikimin e një subjekti të dhënash nga kontrolluesi, i njëjti nuk është i detyruar të mbajë, përfitojë ose përpunojë informacion shtesë për të identifikuar subjektin e të dhënave për qëllimin e vetëm të respektimit të këtij ligji.

2. Nëse në rastet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, kontrolluesi është në gjendje të demonstrojë që ai nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave, me këtë rast kontrolluesi, nëse është e mundshme, e informon subjektin e të dhënave. Në këto raste, nenet 14 deri 19 të këtij ligji nuk zbatohen, përveç kur subjekti i të dhënave, për qëllimet e ushtrimit të të drejtave të tij sipas këtyre neneve, jep informacion shtesë, duke mundësuar identifikimin e tij ose të saj.

KREU III

TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 11

Informimi transparent, komunikimi dhe modalitetet për ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave

1. Kontrolluesi merr masat e përshtatshme për të dhënë çdo informacion të referuar në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji dhe çdo komunikim sipas neneve 14 deri 21 dhe 33 të këtij ligji në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që i nënshtrohen një formati konciz, transparent, të kuptueshëm dhe lehtësisht të qasshëm, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të pastër, veçanërisht për çdo informacion drejtuar specifikisht një fëmije. Informacioni jepet me shkrim ose me mjete të tjera, duke përfshirë, sipas rastit, mjete elektronike. Nëse kërkohet nga subjekti i të dhënave, informacioni mund të jepet me gojë, me kusht që identiteti i subjektit të të dhënave të provohet (dëshmohet) me mjete të tjera.

2. Kontrolluesi lehtëson ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave, sipas neneve 14 deri 21 të këtij ligji. Në rastet e përmendura në nenin 10, paragrafi 2, të këtij ligji kontrolluesi nuk refuzon të veprojë me kërkesën e subjektit të të dhënave për ushtrimin e të drejtave të tij ose të saj sipas neneve 14 deri 21 të këtij ligji, përveç kur kontrolluesi demonstroi që nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave.

3. Kontrolluesi jep informacion mbi veprimet e ndërmarra me kërkesë sipas neneve 14 deri 21 të këtij ligji për subjektin e të dhënave pa vonesë të panevojshme dhe në çdo rast, brenda një (1) muaji nga marrja e kërkesës. Ky afat mund të zgjatet me dy (2) muaj të tjerë nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave. Kontrolluesi njofton subjektin e të dhënave për çdo zgjatje të tillë brenda një (1) muaji nga marrja e kërkesës, së bashku me shkaqet e vonesës. Kur subjekti i të dhënave bën kërkesë me mjete në format

elektronik, informacioni jepet me mjete elektronike, sipas rastit, përveç kur kërkohet ndryshe nga subjekti i të dhënave.

4. Nëse kontrolluesi nuk vepron në lidhje me kërkesën për subjektin e të dhënave, kontrolluesi njofton subjektin e të dhënave pa vonesë dhe jo më vonë se një (1) muaj nga marrja e kërkesës për shkaqet e mosveprimit dhe mbi mundësinë e paraqitjes së ankesës tek Agjencia dhe paraqitjen e një mjeti gjyqësor mbrojtës.

5. Informacioni i dhënë sipas neneve 12 dhe 13 të këtij ligji dhe çdo komunikim dhe masë e ndërmarrë sipas neneve 14 deri 21 dhe 32, të këtij ligji jepet falas. Nëse kërkesat nga një subjekt i të dhënave duket se janë të pabazuara ose të tepërta, veçanërisht për shkak të karakterit të tyre përsëritës, kontrolluesi mund të:

5.1. caktojë një tarifë të arsyeshme, duke marrë parasysh shpenzimet administrative të dhënies së informacionit ose komunikimit, ose marrjen e masës së kërkuar, ose;

5.2. refuzojë të veprojë në lidhje me kërkesën;

5.3. kontrolluesi ka barrën e demonstrimit të karakterit haptazi të pabazuar ose të tepërt të kërkesës.

6. Pa cenuar nenin 10 të këtij ligji, nëse kontrolluesi ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit fizik që bën kërkesën në lidhje me nenet 14 deri 20 të këtij ligji, kontrolluesi mund të kërkojë dhënien e informacionit shtesë të nevojshëm për konfirmimin e identitetit të subjektit të të dhënave.

7. Informacioni, që duhet t'u jepet subjekteve të të dhënave në pajtim me nenet 12 dhe 13 të këtij ligji mund të jepet i kombinuar me (simbolet) ikonat e standardizuara me qëllim që të ofrohet një vështrim i përgjithshëm i përpunimit të synuar në një mënyrë të dukshme, të kuptueshme dhe lehtësisht të lexueshme. Nëse (simbolet) ikonat ofrohen elektronikisht, ato duhet të jenë të lexueshme në mënyrë automatike.

KREU IV INFORMACIONI DHE QASJA NË TË DHËNAT PERSONALE

Neni 12

Informacioni që duhet të jepet nëse të dhënat personale mblidhen nga subjekti i të dhënave

1. Nëse të dhënat personale, në lidhje me një subjekt të dhënash, merren nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi, në momentin kur i merr të dhënat personale, i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm:

1.1. hollësitë e identitetit dhe kontaktit të kontrolluesit dhe sipas rastit, të përfaqësuesit të kontrolluesit;

1.2. hollësitë e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, sipas rastit;

1.3. qëllimin e përpunimit, për të cilin janë të destinuara të dhënat personale, si dhe bazën ligjore për përpunimin;

1.4. nëse përpunimi bazohet në nenin 5, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.6. të këtij ligji, interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesi ose nga një palë e tretë;

1.5. marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale, sipas rastit;

- 1.6. sipas rastit, faktin që kontrolluesi synon të transferojë të dhëna personale te një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare dhe ekzistencën ose mungesën e një vendimi përshtatshmërie të Agjencisë.
2. Përveç informacionit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontrolluesi, në momentin kur pranon të dhënat personale, i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm shtesë të nevojshëm për të garantuar një përpunim të drejtë dhe transparent:
- 2.1. afatin, për të cilin ruhen të dhënat personale, ose nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë afat;
- 2.2. ekzistencën e të drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi qasjen dhe korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, ose kufizimin e përpunimit në lidhje me subjektin e të dhënave, ose për të kundërshtuar përpunimin, si dhe të drejtën për transferueshmërinë e të dhënave;
- 2.3. nëse përpunimi bazohet në nenin 5 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të këtij ligji ose të nenit 8 paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të këtij ligji ekzistencën e të drejtës për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë, pa ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit, bazuar në pëlqimin para tërheqjes së tij;
- 2.4. të drejtën për të paraqitur një ankesë tek Agjencia;
- 2.5. nëse dhënia e të dhënave personale është një kërkesë ligjore ose kontraktuale, ose një kërkesë e nevojshme për të lidhur një kontratë, si dhe nëse subjekti i të dhënave është i detyruar të japë të dhëna personale dhe për pasojat e mundshme për mosdhënien e këtyre të dhënave;
- 2.6. ekzistencën e vendimmarrjes automatike, duke përfshirë profilizimin e përcaktuar në nenin 21 paragrafët 1. dhe 4. të këtij ligji dhe të paktën në ato raste, informacionin e duhur në lidhje me logjikën përkatëse, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të këtij përpunimi për subjektin e të dhënave.
3. Nëse kontrolluesi synon të përpunojë më tej të dhëna personale për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin të dhënat personale janë mbledhur, kontrolluesi, para këtij përpunimi të mëtejshëm, duhet t'i japë subjektit të të dhënave informacion mbi qëllimin tjetër dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, sipas referimit në paragrafin 2. të këtij neni.
4. Paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni nuk zbatohen nëse dhe në masën që subjekti i të dhënave e ka informacionin.

Neni 13

Informacioni që duhet të jepet nëse të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave

1. Nëse informacioni nuk është marrë nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm:
- 1.1. hollësitë e identitetit dhe kontaktit të kontrolluesit dhe, sipas rastit, të përfaqësuesit të kontrolluesit;
- 1.2. hollësitë e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, sipas rastit;
- 1.3. qëllimin e përpunimit për të cilin janë të destinuara të dhënat personale, si dhe bazën ligjore për përpunimin;

1.4. kategoritë e të dhënave personale përkatëse;

1.5. marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale, sipas rastit;

1.6. sipas rastit, që kontrolluesi synon të transferojë të dhëna personale te një marrës në një vend ose organizatë ndërkombëtare dhe ekzistencën ose mungesën e një vendimi përkatës të Agjencisë.

2. Përveç informacionit të referuar në paragrafin 1. të këtij neni, kontrolluesi i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm për të garantuar një përpunim të drejtë dhe transparent në lidhje me subjektin e të dhënave:

2.1. afatin për të cilin ruhen të dhënat personale, ose nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë afat;

2.2. nëse përpunimi bazohet në nenin 5 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.6. të këtij ligji interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesi ose nga një palë e tretë;

2.3. ekzistencën e të drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi qasjen, korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, ose kufizimin e përpunimit në lidhje me subjektin e të dhënave, ose për të kundërshtuar përpunimin, si dhe të drejtën për transferimin e të dhënave;

2.4. nëse përpunimi bazohet në nenin 5 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të këtij ligji ose në nenin 8 paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të këtij ligji ekzistencën e të drejtës për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë, pa ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit, bazuar në pëlqimin para tërheqjes së tij;

2.5. të drejtën për të paraqitur një ankesë tek Agjencia;

2.6. nga cili burim e kanë origjinën të dhënat personale, dhe sipas rastit, nëse kanë ardhur nga një burim i qasshëm publik;

2.7. ekzistencën e vendimmarrjes automatike, duke përfshirë profilizimin, të përmendur në nenin 21 paragrafët 1. dhe 4. të këtij ligji dhe, të paktën në ato raste, informacionin e duhur në lidhje me logjikën përkatëse, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të këtij përpunimi për subjektin e të dhënave.

3. Kontrolluesi jep informacionin e përmendur në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni:

3.1. brenda një afati të arsyeshëm pas marrjes së të dhënave personale, por jo më vonë se një (1) muaj, duke pasur parasysh rrethanat specifike në të cilat përpunohen të dhënat personale;

3.2. nëse të dhënat personale do të përdoren për komunikimin me subjektin e të dhënave, jo më vonë se komunikimi i parë me atë subjekt të dhënash, ose;

3.3. nëse parashikohet deklarimi ndaj një marrësi tjetër, jo më vonë se kur të dhënat personale deklarohen për herë të parë.

4. Nëse kontrolluesi synon të përpunojë më tej të dhëna personale për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin të dhënat personale janë mbledhur, kontrolluesi, para këtij përpunimi të mëtejshëm, duhet t'i japë subjektit të të dhënave informacion mbi qëllimin tjetër dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, sipas referimit në paragrafin 2. të këtij neni.

5. Paragrafët 1. deri 4. të këtij neni nuk zbatohen nëse dhe në masën që:

5.1. subjekti i të dhënave e ka informacionin;

5.2. dhënia e këtij informacioni duket e pamundur ose do të përfshinte një përpjekje joproporcionale, veçanërisht për përpunimin për qëllime arkivimi në interesin publik, qëllime të kërkimeve shkencore ose historike, qëllime statistikore, në pajtim me kushtet dhe garancitë e referuara në nenin 8, paragrafin 3. të këtij ligji ose në masën që detyrimi i referuar në paragrafin 1. të këtij neni mund ta bëjë të pamundur ose rrezikojë seriozisht arritjen e objektivave të këtij përpunimi. Në këto raste, kontrolluesi merr masat e përshtatshme për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të subjekteve të të dhënave, duke përfshirë ofrimin e informacionit publikisht;

5.3. marrja ose deklarimi parashikohet shprehimisht nga legjislacioni përkatës, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi dhe që merr masa të përshtatshme për të mbrojtur interesat legjitime të subjektit të të dhënave, ose;

5.4. nëse të dhënat personale duhet të mbeten konfidenciale, duke iu nënshtuar një detyrimi të fshehtësisë profesionale, të rregulluar nga legjislacioni përkatës, duke përfshirë një detyrim ligjor të fshehtësisë.

Neni 14

E drejta për qasje nga subjekti i të dhënave

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë konfirmimin nga kontrolluesi, nëse po përpunohen ose jo të dhënat që kanë të bëjnë me të dhe, nëse është rasti, të ketë qasje në të dhënat personale dhe informacionin e mëposhtëm:

1.1. qëllimet e përpunimit;

1.2. kategoritë e të dhënave personale përkatëse;

1.3. marrësit ose kategoritë e marrësve, të cilëve u janë deklaruar ose do t'u deklarohen të dhënat personale, veçanërisht marrësit në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare;

1.4. sipas rastit, afati i parashikuar, gjatë të cilit do të ruhen të dhënat personale, ose, nëse nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar atë afat;

1.5. ekzistencën e të drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me subjektin e të dhënave, ose për të kundërshtuar një përpunim të tillë;

1.6. të drejtën për të paraqitur një kërkesë tek Agjencia;

1.7. nëse të dhënat personale nuk mblidhen nga subjekti i të dhënave, çdo informacion i disponueshëm si dhe burimin e tyre;

1.8. ekzistencën e vendimmarrjes së automatizuar, duke përfshirë profilizimin, të përmendur në nenin 21 paragrafët 1. dhe 4. të këtij ligji dhe, të paktën në ato raste, informacionin e duhur në lidhje me logjikën përkatëse, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të këtij përpunimi për subjektin e të dhënave.

2. Nëse të dhënat personale transferohen te një vend i jashtëm ose te një organizatë ndërkombëtare, subjekti i të dhënave ka të drejtën të informohet për garancitë e përshtatshme në lidhje me transferimin.

3. Kontrolluesi jep një kopje të të dhënave personale që i nënshtrohet përpunimit. Për çdo

kopje tjetër të kërkuar nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi mund të caktojë një tarifë të përshtatshme, bazuar në shpenzimet administrative. Nëse subjekti i të dhënave e bën kërkesën me mjete elektronike dhe, përveç kur kërkohet ndryshe nga subjekti i të dhënave, informacioni jepet në një format elektronik të përdorur bashkërisht.

4. E drejta për të përfituar kopjen e përmendur në paragrafin 3. të këtij neni, nuk ndikon negativisht në të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

KREU V KORRIGJIMI DHE FSHIRJA

Neni 15 E drejta e korrigjimit

Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përfitojë nga kontrolluesi, pa vonesë të panevojshme, korrigjimin e të dhënave personale të pasakta në lidhje me të. Duke marrë parasysh qëllimet e përpunimit, subjekti i të dhënave ka të drejtën t'i plotësohen të dhënat personale të paplota, duke përfshirë nëpërmjet bërjes së një deklarimi shtesë.

Neni 16 E Drejta e fshirjes ('E drejta për t'u harruar')

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën që të kërkojë nga kontrolluesi të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, pa vonesë dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, pa vonesë të panevojshme, nëse zbatohet një prej shkaqeve të mëposhtme:

1.1. të dhënat personale nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimet, për të cilat ato janë mbledhur ose përpunuar;

1.2. subjekti i të dhënave e tërheq pëlqimin mbi të cilin bazohet përpunimi sipas nenit 5 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. ose nenit 8 paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të këtij ligji dhe nëse nuk ka shkak tjetër ligjor për përpunimin;

1.3. subjekti i të dhënave e kundërshton përpunimin në pajtim me nenin 20 paragrafi 1. të këtij ligji dhe nuk ka shkaqe legjitime mbizotëruese për përpunimin, ose subjekti i të dhënave e kundërshton përpunimin në pajtim me nenin 20 paragrafi 2. të këtij ligji;

1.4. të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme;

1.5. të dhënat personale duhet të fshihen për të përmbushur një detyrim ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;

1.6. të dhënat personale janë mbledhur në lidhje me ofertën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit të referuara në nenin 7 paragrafi 1. të këtij ligji.

2. Nëse kontrolluesi i ka bërë të dhënat personale publike dhe është i detyruar, sipas paragrafit 1. të këtij neni, t'i fshijë të dhënat personale, kontrolluesi, duke marrë parasysh teknologjinë e disponueshme dhe shpenzimet për zbatimin, ndërmerr hapat e arsyeshëm, duke përfshirë masat teknike, për të informuar kontrolluesit që po përpunojnë të dhënat personale që subjekti i të dhënave ka kërkuar fshirjen nga këta kontrollues të çdo lidhjeje ose kopje, apo përsëritje të këtyre të dhënave personale.

3. Paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni nuk zbatohen në masën që përpunimi është i nevojshëm:

3.1. për ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit;

3.2. për përmbushjen e një detyrimi ligjor që kërkon përpunimin, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi ose për përmbushjen e një detyre në interesin publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar të veshur kontrolluesit;

3.3. për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik në pajtim me nenin 8 paragrafi 2., nën-paragrafët 2.8., 2.9. dhe paragrafit 3. të këtij ligji;

3.4. për qëllime arkivimi në interesin publik ose qëllime të kërkimit shkencor ose historik, ose qëllime statistikore në pajtim me nenin 8, paragrafi 3. të këtij ligji në masën që e drejta e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni mund ta bëjë të pamundur ose ta rrezikojë rëndë arritjen e objektivave të atij përpunimi, ose;

3.5. për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

Neni 17

E drejta e kufizimit të përpunimit

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përftojë nga kontrolluesi kufizimin e përpunimit nëse zbatohet një nga kriteret e mëposhtme:

1.1. saktësia e të dhënave personale kundërshtohet nga subjekti i të dhënave për një afat që i mundëson kontrolluesit të verifikojë saktësinë e të dhënave personale;

1.2. përpunimi është i paligjshëm dhe subjekti i të dhënave e kundërshton fshirjen e të dhënave personale dhe në vend të saj kërkon kufizimin e përdorimit të tyre;

1.3. kontrolluesit nuk vazhdojnë t'i duhen të dhënat personale për qëllimet e përpunimit, por ato kërkohen nga subjekti i të dhënave për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore;

1.4. subjekti i të dhënave e ka kundërshtuar përpunimin në pajtim me nenin 20 paragrafi 1. të këtij ligji në pritje të verifikimit nëse shkaqet legjitime të kontrolluesit mbizotërojnë ndaj atyre të subjektit të të dhënave.

2. Nëse përpunimi është kufizuar sipas paragrafit 1. të këtij neni, këto të dhëna personale, me përjashtim të ruajtjes, përpunohen vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore ose për mbrojtjen e të drejtave të një personi tjetër fizik ose juridik, ose për shkaqe të interesit të rëndësishëm publik;

3. Një subjekt të dhënash që ka përftuar kufizimin e përpunimit në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, informohet nga kontrolluesi para revokimit të kufizimit të përpunimit.

Neni 18

Detyrimi i njoftimit në lidhje me korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit

Kontrolluesi komunikon çdo korrigjim ose fshirje të të dhënave personale ose kufizim të përpunimit të kryer, në pajtim me nenin 15, nenin 16 paragrafi 1. dhe nenin 17, të këtij ligji për çdo marrës, të cilit i janë deklaruar të dhënat personale, përveç kur kjo duket e pamundur ose lidhet me përpjekje joproporcionale. Kontrolluesi njofton subjektin e të dhënave në lidhje me këta marrës, nëse subjekti i të dhënave e kërkon këtë.

Neni 19

E drejta e transferimit të të dhënave

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën për të marrë të dhëna personale në lidhje me të, që ai

ose ajo i ka dhënë kontrolluesit, në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm automatikisht dhe ka të drejtën për të transmetuar ato të dhëna te një kontrollues tjetër, pa pengesë nga një kontrollues, të cilit i janë dhënë të dhënat personale, nëse:

1.1. përpunimi bazohet në pëlqimin, në pajtim me nenin 5 nën-paragrafi 1.1. ose në një kontratë, në pajtim me nenin 6 paragrafët 1. dhe 2. ose nenin 8 nën-paragrafi 2.1. të këtij ligji dhe;

1.2. përpunimi bëhet me mjete automatike.

2. Në ushtrimin e të drejtës së tij ose të saj për transferimin, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, subjekti i të dhënave ka të drejtën për transferimin e të dhënave personale nga një kontrollues në tjetrin, nëse është teknikisht e mundur.

3. Ushtrimi i të drejtës së përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, nuk e prekë neni 16 të këtij ligji. Kjo e drejtë nuk zbatohet në përpunimin e nevojshëm për përmbushjen e një detyre të kryer në interesin publik ose në ushtrim të një autoriteti zyrtar që i është veshur kontrolluesit.

4. E drejta e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni nuk ndikon negativisht në të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

KREU VI

E DREJTA PËR TË KUNDËRSHTUAR DHE VENDIMMARRJA INDIVIDUALE AUTOMATIKE

Neni 20

E drejta për të kundërshtuar

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën që në çdo kohë të kundërshtojë përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, për shkak të një situatë personale të veçantë, nëse bazohet në nenin 5 paragrafin 1., nën-paragrafin 1.6. ose 1.5. të këtij ligji duke përfshirë profilizimin e bazuar në këto dispozita. Kontrolluesi nuk vazhdon të përpunojë të dhëna personale, përveç kur kontrolluesi demonstroi shkaqe detyruese legjitime për përpunimin që mbizotërojnë mbi interesat, të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

2. Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të drejtpërdrejta marketingu, subjekti i të dhënave, në çdo kohë, ka të drejtën të kundërshtojë përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të për këtë marketing, që përfshinë profilizimin në masën që ai lidhet me këtë marketing.

3. Nëse subjekti i të dhënave kundërshton përpunimin për qëllime të drejtpërdrejta marketingu, të dhënat personale nuk vazhdojnë të përpunohen për këto qëllime.

4. Jo më vonë se në momentin e komunikimit të parë me subjektin e të dhënave, e drejta e referuar në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, sillet shprehimisht në vëmendjen e subjektit të të dhënave dhe i paraqitet qartazi dhe veçmas nga çdo informacion tjetër.

5. Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të kërkimeve shkencore ose historike, ose për qëllime statistikore, subjekti i të dhënave, për shkaqe që lidhen me gjendjen e tij ose të veçantë, ka të drejtën të kundërshtojë përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, përveç kur përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre të kryer për shkaqe të interesit publik.

Neni 21**Vendimarrja e automatizuar individuale, duke përfshirë profilizimin**

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të mos i nënshtrohet një vendimi të bazuar vetëm në një përpunim automatik, duke përfshirë profilizimin që prodhon efekte në lidhje me të ose e ndikon në mënyrë të ngjashme atë.

2. Paragrafi 1.i këtij neni nuk zbatohet nëse vendimi:

2.1. është i nevojshëm për të lidhur ose përmbushur një kontratë ndërmjet subjektit të të dhënave dhe një kontrolluesi të dhënash;

2.2. autorizohet nga ndonjë ligj specifik, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi dhe që përcakton edhe masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave, ose;

2.3 bazohet në pëlqimin e qartë të subjektit të të dhënave.

3. Në rastet e referuara në paragrafët 2., nën-paragrafët 2.1. dhe 2.3. të këtij neni, kontrolluesi i të dhënave zbaton masa të përshtatshme për të garantuar të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave, përfshirë të drejtën për të realizuar ndërhyrjen e njeriut nga ana e kontrolluesit, për të shprehur këndvështrimin e tij dhe për të kundërshtuar vendimin.

4. Vendimet e përmendura në paragrafin 2. të këtij neni nuk bazohen në kategoritë e veçanta të të dhënave personale të përmendura në nenin 8, paragrafi 1., të këtij ligji, përveç kur nën-paragrafi 2.1. ose 2.7. i nenit 8 të këtij ligji zbatohet dhe masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave janë në fuqi.

Neni 22**Kufizimet**

1. Të drejtat e subjektit të të dhënave të parashikuara në nenet 4, 11 deri 21, dhe nenin 33 të këtij ligji në masën që dispozitat e saj përputhen me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në nenet 11 deri 21 të këtij ligji, mund të kufizohen nëse një kufizim i tillë respekton thelbin e të drejtave dhe lirive themelore dhe është një masë e nevojshme dhe proporcionale për të garantuar:

1.1. sigurinë shtetërore;

1.2. mbrojtjen;

1.3. sigurinë publike;

1.4. parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin ndaj parandalimit të kërcënimeve për sigurinë publike;

1.5. objektiva të tjera të rëndësishme të interesit të përgjithshëm publik të Republikës së Kosovës, veçanërisht një interes i rëndësishëm ekonomik ose financiar i Republikës së Kosovës, duke përfshirë çështjet monetare, buxhetore ose të tatimeve, shëndetit publik dhe sigurisë sociale;

1.6. mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore dhe të procedimeve gjyqësore;

1.7. parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të shkeljes së etikës për profesionet e rregulluara;

1.8. një funksion monitorues, inspektues ose rregullator që lidhet, edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar, në rastet e përmendura në nën-paragrafët 1.1. deri 1.5. dhe nën-paragrafin 1.7. të këtij neni;

1.9. mbrojtjen e subjektit të të dhënave ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve;

1.10. ekzekutimin e pretendimeve sipas të drejtës civile.

Masat nga paragrafi 1. i këtij neni mund të merren vetëm për atë që është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin është dhënë kufizimi.

KREU VII KONTROLLUESI DHE PËRPUNUESI DETYRIMET E PËRGJITHSHME

Neni 23 Përgjegjësia e kontrolluesit

1. Duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rreziqet me mundësi ndryshimi dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar gatishmërinë për të demonstruar që përpunimi të kryhet në pajtim me këtë ligj. Këto masa rishikohen dhe përditësohen sipas nevojës.

2. Nëse është proporcionale në lidhje me aktivitetet përpunuese, masat e përmendura në paragrafin 1., përfshijnë zbatimin e politikave të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesi.

Neni 24 Mbrojtja e të dhënave në mënyrë konkrete dhe rastësore

1. Duke marrë parasysh gjendjen e teknikës, koston e zbatimit dhe natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rreziqet me mundësi të ndryshueshme dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë që rrjedhin nga përpunimi, kontrolluesi, në momentin e përcaktimit të mjeteve të përpunimit dhe në momentin e vetë përpunimit, zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative, siç është pseudonimizimi, që janë të destinuar për të zbatuar parimet e mbrojtjes së të dhënave, siç është minimizimi i të dhënave, në një mënyrë të efektshme për të integruar garancitë e nevojshme në përpunim, me qëllim që të përmbushen kërkesat e këtij ligji dhe për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave.

2. Kontrolluesi zbaton masat e përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar që, në mënyrë rastësore, të përpunohen vetëm të dhënat personale që janë të nevojshme për secilin qëllim specifik të përpunimit. Ky detyrim zbatohet për tërësinë e të dhënave personale që është mbledhur, masën e përpunimit të tyre, afatin e ruajtjes së tyre dhe qasjen në to. Veçanërisht, këto masa garantojnë që të dhënat personale nuk bëhen të qasshme në mënyrë rastësore pa ndërhyrjen e individit për një numër të pacaktuar të personave fizikë.

3. Një mekanizëm i aprovuar certifikimi sipas referimit në nenin 43 mund të përdoret si një element për të demonstruar përputhshmëri me kërkesat e parashikuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.

Neni 25 Kontrolluesit e përbashkët

1. Nëse dy (2) ose më shumë kontrollues përcaktojnë së bashku qëllimet dhe mjetet e përpunimit, ata quhen kontrollues të përbashkët. Ata përcaktojnë, në një mënyrë transparente,

përgjegjësitë e tyre përkatëse për përputhshmërinë me detyrimet sipas ligjit, veçanërisht në lidhje me ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe detyrat e tyre përkatëse për të dhënë informacionin e referuar në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji, nëpërmjet një mase ndërmjet tyre. Masa mund të përcaktojë një pikë kontakti për subjektet e të dhënave.

2. Masa e referuar në paragrafin 1. të këtij neni pasqyron rolet dhe raportet e kontrolluesve të përbashkët kundrejt subjekteve të të dhënave. Thelbi i masës i bëhet e ditur subjektit të të dhënave.

3. Pavarësisht nga kushtet e masës së përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, subjekti i të dhënave mund të ushtrojë të drejtat e tij ose të saj sipas këtij ligji në lidhje me dhe kundër çdo kontrolluesi.

Neni 26

Përfaqësuesit e kontrolluesit ose përpunuesit që nuk janë vendosur në Kosovë

1. Nëse zbatohet neni 2, paragrafi 3. i këtij ligji, kontrolluesi ose përpunuesi cakton me shkrim një përfaqësues në Republikën e Kosovës.

2. Detyrimi i parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni nuk zbatohet për:

2.1. përpunimin që është rastësor, nuk përfshinë, në masë të madhe, përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave të referuara në nenin 8, paragrafi 1. të këtij ligji ose përpunimin e të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale të referuara në nenin 9 të këtij ligji dhe duket se nuk rezulton në një rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, duke marrë parasysh natyrën, kontekstin, objektin dhe qëllimet e përpunimit, ose;

2.2. një autoritet ose organ publik.

3. Përfaqësuesi autorizohet nga kontrolluesi ose përpunuesi, që të investohet, përveç ose në vend të kontrolluesit ose përpunuesit, veçanërisht nga Agjencia dhe subjektet e të dhënave, për të gjitha çështjet në lidhje me përpunimin, për qëllimet e sigurimit të përputhshmërisë me këtë ligj.

4. Caktimi i një përfaqësuesi nga kontrolluesi ose përpunuesi nuk pengon procedimet gjyqësore që mund të fillohen ndaj vetë kontrolluesit ose përpunuesit.

Neni 27

Përpunuesi

1. Nëse përpunimi duhet të kryhet në emër të një kontrolluesi, i njëjti përdorë vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për të zbatuar masat e përshtatshme teknike dhe organizative në një mënyrë të tillë që përpunimi të përmbushë kërkesat e këtij ligji dhe të garantojë mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave.

2. Përpunuesi nuk angazhon një përpunues tjetër, pa autorizimin paraprak specifik ose të përgjithshëm me shkrim të kontrolluesit. Në rastin e autorizimit të përgjithshëm me shkrim, përpunuesi informon kontrolluesin për çdo ndryshim të synuar në lidhje me shtimin ose zëvendësimin e përpunuesve të tjerë, duke i dhënë kontrolluesit mundësi për të kundërshtuar këto ndryshime.

3. Përpunimi nga një përpunues rregullohet me një kontratë që është detyruese për përpunuesin në lidhje me kontrolluesin dhe që përcakton objektin dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimin e përpunimit, tipin e të dhënave personale dhe kategorive të subjekteve të të dhënave dhe detyrimet dhe të drejtat e kontrolluesit. Kjo kontratë parashikon, veçanërisht, që

përpunuesi:

3.1. përpunon të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të dokumentuara nga kontrolluesi, duke përfshirë në lidhje me transferimet e të dhënave personale te një vend i jashtëm ose një organizatë ndërkombëtare, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga ndonjë ligj specifik, të cilit i nënshtrohet përpunuesi; në një rast të tillë, përpunuesi informon kontrolluesin për këtë kërkesë ligjore para përpunimit, përveç kur ligji e ndalon këtë informim për shkaqe të rëndësishme të interesit publik. Përpunuesi e informon menjëherë kontrolluesin nëse, sipas mendimit të tij, ndonjë udhëzim është në kundërshtim me këtë ligj;

3.2. garanton që personat e autorizuar për të përpunuar të dhënat personale i janë nënshtruar konfidencialitetit ose janë nën detyrimin ligjor të përshtatshëm të konfidencialitetit;

3.3. merr të gjitha masat e kërkuara sipas nenit 31 të këtij ligji;

3.4. respekton kushtet e referuara në paragrafët 2. dhe 4. të këtij neni për angazhimin e një përpunuesi tjetër;

3.5. duke marrë parasysh natyrën e përpunimit, ndihmon kontrolluesin me masa të përshtatshme teknike dhe organizative, në masën që kjo është e mundur, për përmbushjen e detyrimit të kontrolluesit për t'iu përgjigjur kërkesave për ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave;

3.6. ndihmon kontrolluesin në sigurimin e përputhshmërisë me detyrimet, në pajtim me nenet 21 deri 36 të këtij ligji, duke marrë parasysh natyrën e përpunimit dhe informacionin e ofruar përpunuesit;

3.7. sipas zgjedhjes së kontrolluesit, fshinë ose kthen të gjitha të dhënat personale te kontrolluesi pas përfundimit të dhënies së shërbimeve në lidhje me përpunimin dhe fshinë kopjet ekzistuese, përveç kur Ligji mbi Arkivat e kërkon ruajtjen e të dhënave;

3.8. i ofron kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm për të demonstruar përputhshmëri me detyrimet e parashikuara në këtë nen dhe lejon dhe kontribuon për kontrollet, duke përfshirë inspektimet, e zhvilluara nga kontrolluesi ose një auditor tjetër të autorizuar nga kontrolluesi.

4. Nëse një përpunues angazhon një përpunues tjetër për kryerjen e aktiviteteve specifike të përpunimit, në emër të kontrolluesit, të njëjtat detyrime për mbrojtjen e të dhënave, sipas parashikimit në kontratë ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas referimit në paragrafin 3. të këtij neni, i caktohen përpunuesit tjetër nëpërmjet një kontrate, veçanërisht duke dhënë garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave të përshtatshme teknike dhe organizative në një mënyrë të tillë që përpunimi të përmbushë kërkesat e këtij ligji. Nëse përpunuesi tjetër nuk përmbushë detyrimet për mbrojtjen e të dhënave, përpunuesi i parë mbetet tërësisht përgjegjës kundrejt kontrolluesit për përmbushjen e detyrimeve të përpunuesit tjetër.

5. Pa cenuar një kontratë individuale ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit, kontrata, e referuar në paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, mund të bazohet, plotësisht ose pjesërisht, mbi klauzolat standarde kontraktuale të referuara në paragrafët 6. dhe 7. të këtij neni, duke përfshirë kur ata janë pjesë e një certifikimi të dhënë kontrolluesit ose përpunuesit në pajtim me nenin 43.

6. Respektimi i kodit të sjelljes, të miratuar, nga ana e përpunuesit siç referohet në nenin 41 të këtij ligji ose i mekanizmit të certifikimit, të miratuar, siç referohet në nenin 43 të këtij ligji mund të përdoret si element me të cilin do të demonstrohen garanci të mjaftueshme siç referohen në paragrafët 1. dhe 4. të këtij neni.

7. Agjencia mund të vendosë klauzola standarde kontraktuale për çështjet e referuara në paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni.

8. Kontrata e referuar në paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, bëhet me shkrim, duke përfshirë formatin elektronik.

9. Pa cenuar nenet 57, 92 të këtij ligji, nëse një përpunues e shkel këtë ligj, duke përcaktuar qëllimet dhe mjetet e përpunimit, përpunuesi konsiderohet të jetë një kontrollues në lidhje me këtë përpunim.

Neni 28

Përpunimi nën autoritetin e kontrolluesit ose përpunuesit

Përpunuesi dhe çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, i cili ka qasje në të dhënat personale, nuk i përpunon ato të dhëna, përveç se sipas udhëzimeve nga kontrolluesi, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga ndonjë ligj specifik.

Neni 29

Regjistrat e aktiviteteve të përpunimit

1. Çdo kontrollues, përpunues dhe aty ku është e aplikueshme përfaqësuesit e tyre, mbajnë regjistër të aktiviteteve të përpunimit nën përgjegjësinë e tyre. Ky regjistër përmban të gjitha informatat e mëposhtme:

1.1. emrin dhe informatat e kontaktit të kontrolluesit dhe, aty ku është e aplikueshme, të kontrolluesit të përbashkët, përfaqësuesit të kontrolluesit dhe të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave;

1.2. qëllimet e përpunimit;

1.3. një përshkrim të kategorive të subjekteve të të dhënave dhe kategorive të të dhënave personale;

1.4. kategoritë e pranuesve të cilëve u janë zbuluar ose do të zbulohen të dhënat personale duke përfshirë pranuesit në vende të treta ose organizatat ndërkombëtare;

1.5. aty ku është e aplikueshme, transferimi i të dhënave personale në një vend të tretë ose një organizatë ndërkombëtare, duke përfshirë identifikimin e atij vendi të tretë ose organizatës ndërkombëtare, autorizimin sipas nenit 49, paragrafi 2. të këtij ligji dhe, në rastin e transfereve të përmendura në nenin 49 nën-paragrafi 1.9. të këtij ligji, dokumentimin e masave mbrojtëse të përshtatshme;

1.6. aty ku është e mundur, afatet kohore të parashikuara për fshirjen e kategorive të ndryshme të të dhënave;

1.7. aty ku është e mundur, një përshkrim të përgjithshëm të masave teknike dhe organizative të sigurisë të përmendura në nenin 31, paragrafi 1. të këtij ligji.

2. Regjistrat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni duhet të jenë me shkrim, duke përfshirë edhe në formë elektronike.

3. Kontrolluesi ose përpunuesi dhe, ku është e aplikueshme, përfaqësuesi i kontrolluesit ose i përpunuesit, duhet ta vë regjistrin në dispozicion të autoritetit mbikëqyrës sipas kërkesës.

4. Obligimet e referuara në paragrafin 1. të këtij neni nuk zbatohen për ndërmarrjen ose organizatën që punëson më pak se dyqind e pesëdhjetë (250) persona, përveç nëse përpunimi

që ato kryejnë ka gjasa të rezultojë në një rrezik për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, përpunimi nuk është i rastit, ose përpunimi përfshin kategori të veçanta të të dhënave të përmendura në nenin 8 paragrafin 1. të këtij ligji ose të dhënat personale që kanë të bëjnë me dënimet penale dhe veprat penale të përmendura në nenin 9 të këtij ligji.

Neni 30 **Bashkëpunimi me agjencinë**

Kontrolluesi dhe përpunuesi dhe, sipas rastit, përfaqësuesit e tyre, bashkëpunojnë, sipas kërkesës me Agjencinë në përmbushjen e detyrave të tyre.

KREU VIII **SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE**

Neni 31 **Siguria e përpunimit**

1. Duke marrë parasysh gjendjen e teknikës, shpenzimet e zbatimit dhe natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit si dhe rrezikun e mundësisë së ndryshimit, si dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi dhe përpunuesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun, duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit:

1.1. pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale;

1.2. aftësinë për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në vazhdim të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;

1.3. aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe qasjen në të dhënat personale në kohën e duhur, në rastin e një incidenti fizik ose teknik;

1.4. Një proces të testimit, vlerësimit të rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit.

2. Në vlerësimin e nivelit të përshtatshëm të sigurisë duhet të merret parasysh veçanërisht rreziqet që paraqiten nga përpunimi, veçanërisht nga asgjësimi, humbja, ndryshimi aksidental ose i paligjshëm, deklarimi i paautorizuar ose qasja në të dhënat personale të transmetuara, ruajtura ose përpunuara ndryshe.

3. Respektimi i një kodi të aprovuar të sjelljes, sipas referencës në nenin 41 të këtij ligji ose certifikimit të aprovuar sipas referimit në nenin 43 të këtij ligji, mund të përdoret si një element nëpërmjet të cilit të demonstrohet përputhshmëria me kërkesat e parashikuara në paragrafin 1. të këtij neni.

4. Kontrolluesi dhe përpunuesi ndërmerr hapa për të garantuar që çdo person fizik që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, i cili ka qasje në të dhënat personale, nuk i përpunon ato, përveç se sipas udhëzimeve nga kontrolluesi, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga ndonjë ligj specifik.

Neni 32 **Përpunimi i kontraktuar**

1. Përpunuesit të të dhënave mund t'i besohet përpunimi i të dhënave personale me një kontratë të shkruar, për të kryer veprimtari të tilla në pajtim me procedurat dhe masat e sigurisë.

2. Përpunuesi i të dhënave mund të veprojë vetëm brenda kufijve të autorizimeve të kontrolluesit të të dhënave dhe nuk mund të përpunojë të dhënat personale për qëllime të tjera. Të drejtat dhe detyrimet reciproke duhet të caktohen me kontratë të shkruar, e cila po ashtu duhet të përmbajë edhe një përshkrim të detajuar të procedurave dhe masave në pajtim me nenin 32 të këtij ligji.
3. Kontrolluesi i të dhënave duhet të mbikëqyrë zbatimin e procedurave dhe masave në pajtim me nenin 32 të këtij ligji. Po ashtu, duhet të përfshijë edhe vizitat e përkohshme në lokalet ku bëhet përpunimi i të dhënave personale.
4. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet kontrolluesit të të dhënave dhe përpunuesit të të dhënave, përpunuesi i të dhënave duhet menjëherë në kërkesë të kontrolluesit të të dhënave t'i kthejë të gjitha të dhënat që ai ose ajo i posedon. Përpunuesit të të dhënave nuk i lejohet t'i mbajë kopjet dhe t'i përpunojë ato më tutje.
5. Në rast të ndërprerjes së veprimtarive të përpunuesit të të dhënave, të dhënat personale duhet të kthehen menjëherë te kontrolluesi i të dhënave.

Neni 33

Njoftimi i Agjencisë për një shkelje të të dhënave personale

1. Në rastin e një shkeljeje të të dhënave personale, kontrolluesi, pa vonesë dhe sipas rastit, jo më vonë se shtatëdhjetë e dy (72) orë pasi të jetë informuar rreth saj, njofton Agjencinë për shkeljen e të dhënave personale, përveç kur shkelja e të dhënave personale nuk mund të rezultojë në një rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Nëse njoftimi i Agjencisë nuk bëhet brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve, ai shoqërohet me shkaqet e vonesës.
2. Përpunuesit njoftojnë kontrolluesin, pa vonesë të panevojshme, pas ardhjes në dijeni të një shkeljeje të të dhënave personale.
3. Njoftimi i përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, të paktën:
 - 3.1. përshkruan natyrën e shkeljes së të dhënave personale, duke përfshirë, sipas rastit, kategoritë dhe numrin e përafërt të subjekteve të të dhënave dhe kategoritë me numrin e përafërt të regjistrave të të dhënave personale përkatëse;
 - 3.2. komunikon emrin dhe të dhënat e kontaktit të zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave dhe çdo pikë tjetër të kontaktit nëse mund të merret më shumë informacion;
 - 3.3. përshkruan pasojat e mundshme të shkeljes së të dhënave personale;
 - 3.4. përshkruan masat e marra ose të propozuara për t'u marrë nga kontrolluesi për të trajtuar shkeljen e të dhënave personale, duke përfshirë, sipas rastit, masat për të zbutur efektet e mundshme negative.
4. Nëse dhe në masën që nuk është e mundur që informacioni të jepet në të njëjtën kohë, informacioni mund të jepet në faza pa vonesë tjetër të panevojshme.
5. Kontrolluesi dokumenton çdo shkelje të të dhënave personale që përbëhet nga faktet në lidhje me shkeljen e të dhënave personale, efektet e saj dhe veprimi korrigjues i ndërmarrë. Ky dokumentacion i mundëson Agjencisë për të verifikuar përputhshmërinë me këtë nen.

Neni 34

Komunikimi i shkeljes së të dhënave personale subjektivit të të dhënave

1. Nëse shkelja e të dhënave personale mund të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe

liritë e personave fizikë, kontrolluesi ia komunikon shkeljen e të dhënave personale subjektit të të dhënave pa vonesë të panevojshme.

2. Komunikimi drejtuar subjektit të të dhënave personale, sipas referimit në paragrafin 1. të këtij neni, përshkruan në një gjuhë të pastër dhe të qartë natyrën e shkeljes së të dhënave personale dhe përmban të paktën informacionin dhe masat e përmendura në paragrafin 3., nën-paragrafët 3.2., 3.3. dhe 3.4. të nenit 33 të këtij ligji.

3. Komunikimi drejtuar subjektit të të dhënave, të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, nuk kërkohet nëse përmbushet një prej kushteve të mëposhtme:

3.1. kontrolluesi ka zbatuar masa të përshtatshme teknike dhe organizative mbrojtëse dhe këto masa janë zbatuar për të dhënat personale të ndikuara nga shkelja e të dhënave personale, veçanërisht ato që i bëjnë të dhënat personale të pakuptueshme për çdo person që nuk është i autorizuar për t'u qasur në to, si enkriptimi;

3.2. kontrolluesi ka marrë masa të vazhdueshme që garantojnë se rreziku i lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, nuk vazhdon të jetë i mundur për tu realizuar;

3.3. do të kishte të bënte me një përpjekje disproporcionale. Në një rast të tillë, në vend të kësaj, do të ketë një komunikim publik ose një masë të ngjashme, nëpërmjet së cilës, subjektet e të dhënave informohen në një mënyrë njëlloj të efektshme.

4. Nëse kontrolluesi nuk ia ka komunikuar shkeljen e të dhënave personale subjektit të të dhënave, Agjencia, duke marrë parasysh mundësinë që shkelja e të dhënave personale të rezultojë në një rrezik të lartë, mund të kërkojë ta bëjë këtë ose të vendosë që të përmbushet një prej kushteve të referuara në paragrafin 3. të këtij neni.

KREU IX VLERËSIMI I NDIKIMIT MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE DHE KONSULTIMET PARAPRAKE

Neni 35 Vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave

1. Nëse një tip i përpunimit, veçanërisht përdorimi i teknologjisë së re dhe duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, mund të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi, para përpunimit, kryhen një vlerësim të ndikimit të operacioneve të parashikuara të përpunimit mbi përpunimin e të dhënave personale. Një vlerësim i vetëm mund të trajtojë një sërë veprimesh të ngjashme përpunimi që paraqesin rreziqe të larta të ngjashme.

2. Kontrolluesi kërkon këshillën e zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave, nëse është caktuar, në kryerjen e vlerësimit të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave.

3. Një vlerësim i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave, i përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, veçanërisht kërkohet në rastin e:

3.1. një vlerësimi sistematik dhe të zgjatur të aspekteve personale, në lidhje me personat fizikë, i cili bazohet në përpunimin automatik, duke përfshirë profilizimin dhe në të cilin bazohen vendimet që prodhojnë efekte ligjore në lidhje me personat fizikë ose ndikojnë në masë të ngjashme personin fizik;

3.2. përpunimit në shkallë të gjerë të kategorive të veçanta të të dhënave të përmendura

në nenin 8, paragrafi 1. të këtij ligji, ose të të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale të përmendura në nenin 9 të këtij ligji, ose;

3.3. një monitorimi sistematik të një zone me qasje publike në një shkallë të gjerë.

4. Agjencia përpilon dhe bënë publike një listë për llojin e veprimeve të përpunimit që i nënshtrohen kërkesës së një vlerësimi të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.

5. Agjencia mund të përpilojë dhe bëjë publike një listë me llojin e veprimeve të përpunimit, për të cilat nuk kërkohet vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave.

6. Vlerësimi, të paktën, përmban:

6.1. një përshkrim sistematik të veprimeve të përpunimit të parashikuar dhe qëllimet e përpunimit, duke përfshirë, sipas rastit, interesin legjitim të ndjekur nga kontrolluesi;

6.2. një vlerësim të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të operacioneve të përpunimit në lidhje me qëllimet;

6.3. një vlerësim të rreziqeve për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe;

6.4. masat e parashikuara për të trajtuar rreziqet, duke përfshirë garancitë, masat e sigurisë dhe mekanizmat për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe për të demonstruar përputhshmëri me këtë ligj, duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat legjitime të subjekteve të të dhënave dhe personave të tjerë të interesuar.

7. Respektimi i kodeve të aprovuara të sjelljes, të referuar në nenin 41 të këtij ligji nga kontrolluesit ose përpunuesit, merren parasysh në vlerësimin e ndikimit të veprimeve të përpunimit, të kryera nga këta kontrollues ose përpunues, veçanërisht për qëllimet e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave.

8. Sipas rastit, kontrolluesi kërkon mendimet e subjekteve të të dhënave ose përfaqësuesve të tyre mbi përpunimin e synuar, pa cenuar mbrojtjen e interesave tregtare ose publike ose sigurinë e veprimeve të përpunimit.

9. Nëse përpunimi, në pajtim me nenin 5, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. ose 1.5. të këtij ligji ka një bazë ligjore në ndonjë ligj specifik, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi, kjo e drejtë rregullon operacionet specifike të përpunimit ose kompletin e operacioneve në fjalë dhe një vlerësim i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave është kryer si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm të ndikimit në kontekstin e miratimit të asaj baze ligjore, paragrafët 1. deri 6. të këtij neni nuk aplikohen, përveç në rastet kur Agjencia e konsideron të nevojshme për të kryer një vlerësim të tillë para aktiviteteve përpunuese.

10. Sipas rastit, kontrolluesi kryen një rishikim për të vlerësuar nëse përpunimi kryhet në pajtim me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave, të paktën kur ka një ndryshim të rrezikut të përfaqësuar nga veprimet e përpunimit.

Neni 36 Konsultimi paraprak

1. Kontrolluesi konsultohet me Agjencinë para përpunimit, nëse vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave, sipas nenit 35 të këtij ligji, tregon që përpunimi do të rezultonte në një rrezik të lartë në mungesë të masave të marra nga kontrolluesi për të zbutur rrezikun.

2. Nëse Agjencia është e mendimit që përpunimi i synuar, i referuar në paragrafin 1. të këtij neni, do të shkelte këtë ligj, veçanërisht nëse kontrolluesi ka identifikuar ose zbutur rrezikun në masë të pamjaftueshme, Agjencia, brenda një afati deri në tetë (8) javë nga marrja e kërkesës për konsultim, i paraqet kontrolluesit këshillë me shkrim dhe nëse zbatohet për përpunuesin mund të përdorë një prej kompetencave të përmendura në nenin 64 të këtij ligji. Ky afat mund të zgjatet gjashtë (6) javë, duke marrë parasysh kompleksitetin e përpunimit të synuar. Agjencia informon kontrolluesin dhe, sipas rastit, përpunuesin, për çdo zgjatje të tillë brenda një (1) muaji nga marrja e kërkesës për konsultime së bashku me shkaqet e vonësës. Këto afate mund të pezullohen derisa Agjencia të ketë përfituar informacionin që ai ka kërkuar për qëllimet e konsultimeve.

3. Gjatë konsultimit me Agjencinë, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, kontrolluesi i paraqet Agjencisë:

3.1. sipas rastit, përgjegjësitë përkatëse të kontrolluesit, kontrolluesit të përbashkët dhe përpunuesve të përfshirë në përpunim, veçanërisht për përpunimin brenda një grupi ndërmarrjesh;

3.2. qëllimet dhe mjetet e përpunimit të synuar;

3.3. masat dhe garancitë e parashikuara për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave në pajtim me këtë ligj;

3.4. sipas rastit, hollësitë e kontaktit për zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave;

3.5. vlerësimin e ndikimit të mbrojtjes së të dhënave, të parashikuar në nenin 35 të këtij ligji, dhe;

3.6. çdo informacion tjetër të kërkuar nga Agjencia.

4. Pavarësisht paragrafit 1. të këtij neni, Agjencia mund të kërkojë që kontrolluesit të konsultohen dhe të marrin autorizim paraprak në lidhje me përpunimin nga një kontrollues për kryerjen e një detyre që përmbushet nga kontrolluesi në interes publik, duke përfshirë përpunimin në lidhje me mbrojtjen sociale dhe shëndetin publik.

KREU X ZYRTARI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 37 Caktimi i zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave

1. Kontrolluesi dhe përpunuesi caktojnë një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave në çdo rast, nëse:

1.1. përpunimi kryhet nga një organ publik, përveç gjykatave që veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore;

1.2. aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga veprimet përpunuese që në saxe të natyrës, objektit dhe/ose qëllimit të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjektit të të dhënave në një shkallë të gjerë, ose;

1.3. aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga përpunimi në një shkallë të gjerë të kategorive të veçanta, në pajtim me nenin 8 të këtij ligji dhe të dhëna personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale të referuara në nenin 9 të këtij ligji.

2. Një grup ndërmarrjesh mund të caktojë një zyrtar të vetëm për mbrojtjen e të dhënave, me

kusht që një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave të jetë lehtësisht i qasshëm nga çdo strukturë.

3. Nëse kontrolluesi ose përpunuesi është një organ publik, mund të caktohet një zyrtar i vetëm për mbrojtjen e të dhënave për disa organe të tilla, duke pasur parasysh strukturën e tyre organizative dhe madhësinë.

4. Në raste të ndryshme nga ato të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, kontrolluesi ose përpunuesi, ose shoqatat, ose organet e tjera që përfaqësojnë kategori të kontrolluesve ose përpunuesve, mund të caktojnë një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave mund të veprojë për këto shoqata ose organe të tjera që përfaqësojnë kontrolluesit ose përpunuesit.

5. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave caktohet mbi bazën e cilësive profesionale dhe veçanërisht, ekspertizës për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave, praktika dhe aftësia për të përmbushur detyrat e përmendura në nenin 39 të këtij ligji.

6. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave mund të jetë anëtar personeli i kontrolluesit ose përpunuesit, ose të përmbushë detyrat mbi bazën e një kontrate shërbimi.

7. Kontrolluesi ose përpunuesi publikon hollësitë e kontaktit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave dhe ia komunikon ato Agjencisë.

Neni 38

Pozicioni i zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave

1. Kontrolluesi dhe përpunuesi garantojnë që zyrtari për mbrojtjen e të dhënave përfshihet në mënyrën dhe kohën e duhur, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi dhe përpunuesi mbështetë zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave në përmbushjen e detyrave të referuara në nenin 39 të këtij ligji duke parashikuar masat e nevojshme për të kryer ato detyra dhe për t'u qasur në veprimet e përpunimit të të dhënave personale dhe për të mbajtur ekspertizën e vet.

3. Kontrolluesi dhe përpunuesi garantojnë që zyrtari për mbrojtjen e të dhënave nuk merr udhëzime në lidhje me ushtrimin e këtyre detyrave. Ai ose ajo nuk pushohet apo penalizohet nga kontrolluesi ose përpunuesi për përmbushjen e detyrave të tij. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave raporton drejtpërdrejt në nivelin më të lartë menaxhues të kontrolluesit ose përpunuesit.

4. Subjektet e të dhënave mund të kontaktojnë zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me çështjet që i takojnë përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe për ushtrimin e të drejtave të tyre sipas këtij ligji.

5. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave i nënshtrohet fshehtësisë ose konfidencialitetit në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij ose të saj.

6. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave mund të përmbushë detyra të tjera. Kontrolluesi ose përpunuesi garantojnë që çdo detyrë tjetër e tillë nuk rezulton në konflikt interesash.

Neni 39

Detyrat e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave

1. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave ka, të paktën, detyrat e mëposhtme:

1.1. informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave;

1.2. jep këshilla, sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën në pajtim me nenin 35 të këtij ligji;

1.3. bashkëpunon me Agjencinë;

1.4. vepron si pikë kontakti për Agjencinë për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak, të referuar në nenin 36 të këtij ligji dhe konsultohet, sipas rastit, në lidhje me çdo çështje tjetër.

2. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave, në përmbushje të detyrave të tij ose të saj, merr parasysht si duhet rrezikun që shoqëron veprimet e përpunimit, duke marrë parasysht natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit.

Neni 40

Obligimi për nxjerrjen e akteve të brendshme

1. Kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave duhet të kujdesen, në çdo kohë, që të dhënat të mbrohen dhe përpunohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.

2. Kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave duhet të përshkruajnë, në aktet e tyre të brendshme, procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale dhe duhet të emërojnë, në formë të shkruar, personat kompetentë që janë përgjegjës për të zbatuar rregullat sipas këtij ligji.

Neni 41

Kodet e sjelljes

1. Agjencia inkurajon hartimin e kodeve të sjelljes që synojnë të kontribuojnë në zbatimin e duhur të këtij ligji, duke marrë parasysht karakteristikat specifike të sektorëve të ndryshëm të përpunimit.

2. Shoqatat dhe organet e tjera që përfaqësojnë kategoritë e kontrollueseve ose përpunuesve mund të përgatisin kode të sjelljes, ose të ndryshojnë ose zgjerojnë kode të tilla, në lidhje me:

2.1. përpunim të drejtë dhe transparent;

2.2. interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesit në kontekste specifike;

2.3. mbledhjen e të dhënave personale;

2.4. pseudonimizimin e të dhënave personale;

2.5. informatat e ofruar për publikun dhe subjektet e të dhënave;

2.6. ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave;

2.7. informatat e ofruara fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, si dhe mënyrën në të cilën duhet të merret pëlqimi i bartësve të përgjegjësishë prindërore mbi fëmijët;

2.8. masat dhe procedurat e referuara në nenet 23 dhe 24 të këtij ligji, dhe masat për të siguruar sigurinë e përpunimit të përmendur në nenin 31 të këtij ligji;

2.9. njoftimin e shkeljeve të të dhënave personale tek Agjencia dhe komunikimin e shkeljeve të të dhënave personale tek subjektet e të dhënave;

2.10. transferimi i të dhënave personale në vende të treta ose organizata ndërkombëtare, ose;

2.11. procedurat jashtëgjyqësore dhe procedurat e tjera për zgjidhje të kontesteve ndërmjet kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave lidhur me përpunimin, pa paragjykuar të drejtat e subjekteve të të dhënave në përputhje me nenet 52 deri 54 të këtij ligji.

3. Përveç përputhshmërisë nga ana e kontrolluesve ose përpunuesve që i nënshtrohen këtij ligji, kodet sjelljes të miratuara në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni dhe që kanë vlefshmëri të përgjithshme sipas paragrafit 6. të këtij neni po ashtu mund të respektohen nga kontrolluesit ose përpunuesit që nuk i nënshtrohen këtij ligji, në pajtim me nenin 2, me qëllim që të sigurojnë masa mbrojtëse të duhura në kuadër të transferimeve të të dhënave personale në vende të treta ose organizata ndërkombëtare.

4. Kodi i sjelljes i referuar në paragrafin 2. të këtij neni përmban mekanizma që i japin mundësi autoritetit kompetent të kryejë monitorimin e detyrueshëm të përputhjes së kontrolluesve ose përpunuesve të cilët marrin përsipër zbatimin e tij me dispozitat e tij.

5. Shoqatat dhe organet e tjera të përmendura në paragrafin 2. të këtij neni, që synojnë të përgatisin kodin e sjelljes, ose të ndryshojnë ose plotësojnë ndonjë kod ekzistues, duhet të dorëzojnë në Agjenci projekt kodin, ndryshimin ose plotësimin. Agjencia do të jap një mendim nëse projekt kodi, ndryshimi ose plotësimi është në përputhje me këtë ligj dhe e miraton atë projekt kod, ndryshimin ose plotësimin nëse konstaton se ai siguron masa mbrojtëse të mjaftueshme.

6. Kur projekt kodi, ndryshimi ose plotësimi, miratohet në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, Agjencia e regjistron dhe e publikon atë kod.

Neni 42

Monitorimi i kodeve të miratuara të sjelljes

1. Pa paragjykuar detyrat dhe kompetencat e Agjencisë sipas neneve 57, 64 dhe 65 të këtij ligji, monitorimi i përputhshmërisë me kodin e sjelljes mund të kryhet nga një organ që ka nivel të duhur të ekspertizës në lidhje me çështjen tematike të kodit dhe që është i akredituar për atë qëllim nga Agjencia.

2. Organi, siç referohet në paragrafin 1. të këtij neni mund të akreditohet për të monitoruar përputhshmërinë me kodin e sjelljes kur ai organ ka:

2.1. demonstruar pavarësinë dhe ekspertizën e tij në lidhje me çështjen tematike të kodit të pranueshëm nga Agjencia;

2.2. përcaktuar procedura që i lejojnë të vlerësojë përshtatshmërinë e kontrolluesve dhe përpunuesve përkatës për zbatimin e kodit, për të monitoruar përputhshmërinë e tyre me dispozitat e tij dhe për të rishikuar periodikisht funksionimin e tij;

2.3. përcaktuar procedura dhe struktura për të trajtuar ankesat për shkeljet e kodit ose për mënyrën në të cilën kodi është zbatuar ose po zbatohet nga kontrolluesi ose përpunuesi, dhe për t'i bërë ato procedura dhe struktura transparente për subjektet e të dhënave dhe publikun, dhe;

2.4. demonstruar për Agjencinë që detyrat e tij nuk rezultojnë në konflikt interesi.

3. Agjencia përcakton kritere për akreditimin e një organi nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Pa paragjykim ndaj detyrave dhe kompetencave të Agjencisë, organi nga paragrafi 1. i këtij neni, duke iu nënshtuar masave të duhura mbrojtëse, merr masat e duhura në rastet e shkeljes së kodit nga ana e kontrolluesit ose përpunuesit, duke përfshirë suspendimin ose përjashtimin

e kontrolluesit ose përpunuesit në fjalë nga kodi. Ai duhet të informojë Agjencinë për veprimet e tilla dhe arsyet për marrjen e tyre.

5. Agjencia e revokon akreditimin e ndonjë organi sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse kushtet për akreditim nuk përmbushen ose pushojnë së përmbushuri, ose kur veprimet e ndërmarra nga organi shkelin këtë ligj.

6. Ky nen nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet dhe organet publike.

Neni 43 Certifikimi

1. Kontrolluesve, përpunuesve si dhe personave juridikë/ndërmarrjeve, të cilat përpunojnë të dhëna sipas fushë veprimtarisë së këtij ligji, u jepet certifikatë për të kryer punën që lidhet me të dhëna personale.

2. Certifikata lëshohet nga Agjencia në bazë të kriterëve dhe procedurave të parapara me akt nënligjor.

3. Për të marrë certifikatën, kontrolluesit, përpunuesit dhe personat juridikë/ndërmarrjet plotësojnë të paktën kushtet minimale në vijim:

3.1. dëshmojnë që posedojnë njohuri adekuate në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

3.2. aty ku kërkohet, plotësojnë standardet e nevojshme ndërkombëtare të sigurisë;

3.3. në rastet kur personat juridikë/ndërmarrjet angazhojnë kontrollues, përpunues dhe personel tjetër të cilët kanë marrë certifikimin;

3.4. dëshmojnë që ushtrimi i funksioneve të tyre për sa i përket mbrojtjes së të dhënave, nuk rezulton me konflikt interesi.

4. Nëse personi juridik/ndërmarrja posedon certifikatë të lëshuar nga një institucion apo organ kompetent evropian, ajo certifikatë vlen edhe në Republikën e Kosovës.

5. Kontrolluesi, përpunuesi apo personi juridik/ndërmarrja që paraqet kërkesë për t'u certifikuar, i paraqet Agjencisë të gjitha informacionet dhe i jep qasje asaj në veprimtarinë përpunuese, të cilat janë të domosdoshme për të zhvilluar procedurën e certifikimit.

6. Certifikata lëshohet për një periudhë kohore prej maksimalisht tri (3) vitesh dhe mund të përtërihet, sipas të njëjtave kushte, me kusht që kërkesat relevante vazhdojnë të jenë të plotësuar. Certifikimi tërhiqet, siç aplikohet, nga Agjencia, atëherë kur kërkesat për certifikim nuk janë plotësuar apo nuk vazhdojnë të jenë të plotësuar.

7. Përveç respektimit të këtij ligji nga kontrolluesit apo përpunuesit, Agjencia mund të themelojë mekanizma të certifikimit të mbrojtjes së të dhënave me qëllim të demonstrimit të ekzistencës së masave të përshtatshme të sigurisë të ofruara nga kontrolluesit apo përpunuesit që nuk u nënshtrohen këtij ligji sipas nenit 2 të këtij ligji brenda kornizës së transferimit të të dhënave personale në vende të treta apo në organizata ndërkombëtare. Kontrolluesit apo përpunuesit e tillë, përmes instrumenteve kontraktuale, bëjnë përpjekje të detyrueshme dhe të zbatueshme që të aplikojnë ato masa të përshtatshme të sigurisë, përfshirë edhe të drejtat e subjekteve të të dhënave.

8. Një certifikim, sipas këtij neni, nuk e zvogëlon përgjegjësinë e kontrolluesit apo përpunuesit për të zbatuar këtë ligj dhe si i tillë nuk paragjkon detyrat dhe autorizimet e Agjencisë.

KREU XI
TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE TE SHTETET TJERA DHE ORGANIZATAT
NDËRKOMBËTARE

Neni 44
Dispozitat e përgjithshme

Transferimi i të dhënave personale, të cilat janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera dhe tek organizatat ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe në qoftë se vendi ose organizata ndërkombëtare në fjalë siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.

Neni 45
Procedura për përcaktimin e nivelit të duhur për mbrojtjen e të dhënave personale

Vendet dhe organizatat ndërkombëtare konsiderohen se sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse Agjencia ka marrë një vendim formal dhe ato vende apo organizata janë përfshirë në listën përkatëse të nxjerrë nga Agjencia në pajtim me këtë ligj.

Neni 46
Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave

1. Agjencia mbanë një listë të vendeve dhe të organizatave ndërkombëtare ose një apo më shumë sektorë të specifikuar brenda tyre, për të cilat ajo konstaton se ato sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, në pajtim me këtë ligj.
2. Për përpilimin e listës së paraparë në paragrafin 1. të këtij neni, Agjencia mund të zbatojë vendimet e marra nga organi kompetent i Bashkimit Evropian, nëse vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.
3. Agjencia publikon listën nga paragrafi 1. i këtij neni në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në faqen publike të saj.

Neni 47
Vendimet për nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave nga vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare

1. Agjencia, në vendimmarrjen e saj mbi nivelin adekuat të mbrojtjes së të dhënave personale të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare, përcakton të gjitha rrethanat që lidhen me transferimin e të dhënave personale. Në veçanti, duke marrë parasysh elementet në vijim:

1.1. sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, legjislacionin relevant, atij të përgjithshëm dhe sektorial, përfshirë atë që ka të bëjë me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë shtetërore dhe të drejtën penale, si dhe qasjen e autoriteteve publike në të dhënat personale, si dhe zbatimin e legjislacionit të tillë, rregullat e mbrojtjes së të dhënave, rregullat profesionale dhe masat e sigurisë, përfshirë rregullat për transferimin e mëtejme të të dhënave personale në një vend tjetër të tretë apo organizatë ndërkombëtare të cilat zbatohen në atë vend apo organizatë ndërkombëtare, precedenca, si dhe të drejtat efektive dhe të zbatueshme të subjekteve të të dhënave dhe rivendosja efektive administrative dhe gjyqësore për subjektet e të dhënave, të dhënat personale të të cilave transferohen;

1.2. ekzistimi i funksionimit efektiv të një apo më shumë autoriteteve të pavarura mbikëqyrëse në vendin e tretë apo të cilës i nënshtrohet një organizatë ndërkombëtare, me përgjegjësinë për të siguruar dhe zbatuar pajtueshmërinë me rregullat mbi mbrojtjen

e të dhënave, përfshirë autorizimet adekuate të zbatimit, për të ndihmuar dhe këshilluar subjektet e të dhënave në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe për bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse;

1.3. përkushtimet ndërkombëtare që ka marrë përsipër vendi i tretë apo organizata ndërkombëtare, apo obligimet e tjera që dalin nga konventat apo instrumentet ligjërish të detyrueshme, si dhe nga pjesëmarrja e tyre në sistemet shumëpalëshe apo regjionale, në veçanti në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;

1.4. lloji i të dhënave personale që duhet përpunuar;

1.5. qëllimi dhe kohëzgjatja e përpunimit të propozuar;

1.6. rregullimi ligjor në vendin e origjinës dhe shteti pranues, përfshirë rregullimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të huaj;

1.7. masat për të siguruar të dhënat personale të shfrytëzuara në vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare.

2. Agjencia, në vendimmarrjen e saj nga paragrafi 1. i këtij neni, veçanërisht merr parasysh:

2.1. nëse të dhënat personale të transferuara që duhen transferuar do të jenë apo janë shfrytëzuar vetëm për qëllimin për të cilin janë transferuar apo nëse qëllimi mund të ndryshojë vetëm mbi bazën e lejes së kontrolluesit të të dhënave që i jep të dhënat, apo mbi bazën e pëlqimit personal të subjektit të të dhënave;

2.2. nëse subjekti i të dhënave ka mundësinë e përcaktimit të qëllimit për të cilin të dhënat e tij/saj do të përdoren, kujt po i jepen dhe mundësinë e përmirësimit apo fshirjes së të dhënave personale joadekuate apo të vjetruara, përveç nëse kjo parandalohet për shkak të fshehtësisë së procedurës nga traktatet e detyrueshme ndërkombëtare;

2.3. nëse kontrolluesi apo përpunuesi i huaj i të dhënave kryen procedura dhe masa adekuate organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat;

2.4. nëse është caktuar një person kontaktues i autorizuar për të ofruar informata për subjektin e të dhënave apo për Agjencinë mbi përpunimin e të dhënave personale të transferuara;

2.5. nëse pranuesi i jashtëm (i huaj) i të dhënave mund të transferojë më tutje të dhënat personale vetëm me kushtin që një pranues tjetër i jashtëm i të dhënave, të cilit do t' i shpalosen të dhënat personale, ofron mbrojtje adekuate të të dhënave personale edhe për qytetarët e huaj;

2.6. nëse është ofruar mbrojtje efektive ligjore për subjektet e të dhënave, të dhënat personale të të cilëve ishin apo po transferohen.

3. Agjencia rishikon në baza periodike këtë listë, të paktën çdo katër (4) vjet, e cila merr parasysh të gjitha zhvillimet relevante në vendin e tretë apo organizatën ndërkombëtare që do të ndikonte në përhershmerinë e listës.

4. Në rastet kur ekziston informacion që zbulon se vendi i tretë, një apo më shumë sektorë të specifikuar brenda vendit të tretë apo një organizatë ndërkombëtare, nuk ofron më nivel adekuat të mbrojtjes brenda kuptimit të paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, Agjencia, në masën e nevojshme, përmirëson apo pezullon vendimin e përfshirjes në listë përmes zbatimit të akteve pa efekt retroaktiv.

Neni 48

Kriteret për vendimmarrje

Agjencia me akt nënligjor, përcakton, në mënyrë të detajuar, se cili informacion është i domosdoshëm për të vendosur nëse shteti tjetër ose organizata ndërkombëtare siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale, siç është paraparë me këtë ligj.

Neni 49

Autorizimi për transferin e të dhënave tek shteti apo organizata ndërkombëtare që nuk siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave

1. Pavarësisht nga neni 45 i këtij ligji, Agjencia mund të autorizojë transferimin apo publikimin e të dhënave personale në një shtet apo organizatë ndërkombëtare që nuk siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse përmbushet një apo më shumë nga kushtet e mëposhtme:

1.1. kështu parashihet me një ligj tjetër apo me një traktat ndërkombëtar të detyrueshëm;

1.2. subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin dhe është i vetëdijshëm për pasojat e transferimit;

1.3. transferimi është i domosdoshëm për jetësimin e një kontrate midis subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit të të dhënave, apo për zbatimin e masave parakontraktuale të ndërmarra në kundërpërgjigje ndaj kërkesave të subjektit të të dhënave;

1.4. transferimi është i domosdoshëm për përmbylljen apo jetësimin e një kontrate të lidhur në interes të subjektit të të dhënave midis kontrolluesit të të dhënave dhe palës së tretë;

1.5. transferimi është i domosdoshëm dhe i kërkuar ligjërisht në bazë të interesit të rëndësishëm publik;

1.6. transferimi është i domosdoshëm për të mbrojtur jetën dhe trupin e subjektit të të dhënave;

1.7. transferimi është i domosdoshëm për ngritjen, ushtrimin apo mbrojtjen e kërkesave ligjore;

1.8. transferimi bëhet nga një regjistër i cili sipas ligjeve apo rregulloreve ka për synim të sigurojë informacione për publikun dhe që është i hapur për konsultime nga publiku në përgjithësi apo nga ndonjë person i cili mund të demonstrojë interesa legjitime, deri në atë masë që të përmbushen kushtet e parashtruara për konsultime në këtë rast të veçantë. Në këtë rast, transferimi nuk përfshinë tërësinë e të dhënave personale apo të gjitha kategoritë e të dhënave personale që përmban regjistri. Kur regjistri ka për qëllim konsultimin nga personat që kanë interes legjitim, transferimi bëhet vetëm me kërkesë të atyre personave apo nëse ata pritet të jenë pranues;

1.9. kontrolluesi i të dhënave aplikon masa adekuate të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e liritë themelore të individëve për sa i përket ushtrimit të të drejtave të parashtruara. Masat e tilla të sigurisë mund të rezultojnë nga dispozitat e kontratës apo kushteve të përgjithshme të aktiviteteve biznesore që rregullojnë transferimin e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi i të dhënave mund të transferojë të dhëna personale vetëm me pranimin e autorizimit sipas paragrafit 1. të këtij neni. Në kërkesën e tij/saj për autorizim, kontrolluesi i të dhënave i ofron Agjencisë të gjitha informatat e domosdoshme për sa i përket transferimit të kërkuar të të dhënave personale. Kjo përfshinë, në veçanti, kategoritë e të dhënave, qëllimin e

transferimit dhe masat e aplikuara të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale në shtetin tjetër apo organizatën ndërkombëtare.

3. Agjencia vendosë për aplikimin nga paragrafi 2. i këtij neni pa vonesë dhe përcakton me akt nënligjor hollësitë dhe procedurat e brendshme për plotësimin e kërkesave të tilla. Vendimi i lartpërmendur është përfundimtar në procedurë administrative, por pranohet kontestimi administrativ pranë gjykatës kompetente.

Neni 50

Regjistrimi i autorizimeve

Autorizimet lidhur me transferimin e të dhënave personale në vendin tjetër apo organizatën ndërkombëtare, të dhëna nga Agjencia, duhet të regjistrohen në pajtim me nën-paragrafin 1.5. të paragrafit 1., të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 51

Njohja dhe zbatimi i kërkesave të vendeve të treta për transfer

Aktgjykimet gjyqësore dhe çdo vendim i autoriteteve administrative të vendeve të treta që kërkojnë nga kontrolluesit apo përpunuesit transferimin apo zbulimin e të dhënave personale, mund të njihen apo të zbatohen vetëm bazuar në marrëveshjen ndërkombëtare ndërmjet vendit të tretë që bën kërkesën dhe Republikës së Kosovës, pa paragjykim ndaj arsyeve për transfer sipas këtij ligji.

KREU XII

MJETET E ANKIMIT, PËRGJEGJËSIA DHE DËNIMET

Neni 52

E drejta për të paraqitur ankesë tek agjencia

1. Pa cenuar mjetet e tjera administrative ose gjyqësore të mbrojtjes, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të paraqesë ankesë tek Agjencia, nëse subjekti i të dhënave pretendon që përpunimi i të dhënave personale, në lidhje me të, e shkelë këtë ligj.

2. Agjencia njofton ankuesin mbi progresin dhe rezultatin e ankesës, duke përfshirë mundësinë e një mjeti ankimi gjyqësor, në pajtim me nenin 54 të këtij ligji.

Neni 53

E drejta për një mjet gjyqësor të efektshëm ndaj Agjencisë

1. Pa penguar mjetet e tjera administrative ose jo gjyqësore të mbrojtjes, secili person fizik ose juridik ka të drejtën e një mjeti gjyqësor të efektshëm ndaj një vendimi, ligjërisht detyrues, të Agjencisë, në lidhje me të.

2. Pa penguar mjetet e tjera administrative ose jo gjyqësore të mbrojtjes, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtën e një mjeti gjyqësor të efektshëm, nëse Agjencia, në bazë të kompetencave të saj, nuk e trajton një ankesë ose nuk e njofton subjektin e të dhënave brenda tre (3) muajve mbi përparimin ose rezultatin e ankesës së paraqitur në pajtim me nenin 52 të këtij ligji.

3. Ndaj vendimit përfundimtar të Komisionerit, pala e pakënaqur ka të drejtë të hapë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.

Neni 54**E drejta për një mjet gjyqësor të efektshëm ndaj një kontrolluesi ose përpunuesi**

Pa cenuar asnjë mjet të disponueshëm administrativ ose jo gjyqësor mbrojtjeje, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur një ankim tek Agjencia, në pajtim me nenin 53 të këtij ligji, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtën për një mjet të efektshëm gjyqësor, nëse ai ose ajo është i mendimit se të drejtat e tij ose të saj, sipas këtij ligji, janë shkelur si rezultat i përpunimit të të dhënave të tij ose të saj personale në mospërputhje me këtë ligj.

Neni 55**Përfaqësimi i subjektit të të dhënave**

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të autorizojë një përfaqësues, një organ, organizatë ose shoqatë jofitimprurëse që është krijuar në mënyrë të rregullt, në pajtim me legjisllacionin në fuqi, që ka objektiva ligjore që janë në interesin publik dhe është aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të subjekteve të të dhënave, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, të paraqesë një ankesë në emër të tij/saj, të ushtrojë të drejtat e referuara në nenet 53, 54 dhe 55 të këtij ligji në emër të tij ose të saj dhe të ushtrojë të drejtën për të marrë kompensimin e referuar në nenin 56 të këtij ligji në emër të tij ose të saj.

2. Autorizimi për përfaqësuesin duhet të jepet me shkrim dhe të vërtetohet nga organi kompetent.

Neni 56**E drejta për kompensim dhe përgjegjësia**

1. Çdo person, i cili ka pësuar dëm material ose jomaterial, si rezultat i një shkeljeje të këtij ligji, ka të drejtë të marrë kompensim nga kontrolluesi ose përpunuesi për dëmin e pësuar.

2. Çdo kontrollues i përfshirë në përpunim është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga përpunimi që shkel këtë ligj. Një përpunues është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga përpunimi vetëm nëse ai nuk ka përmbushur detyrimet e këtij ligji, veçanërisht drejtuar përpunuesve ose nëse ka vepruar më tej ose në kundërshtim me udhëzimet e ligjshme të kontrolluesit.

3. Një kontrollues ose përpunues përjashtohet nga përgjegjësia, sipas paragrafit 2. të këtij neni, nëse ai dëshmon që nuk është në asnjë mënyrë përgjegjës për dëmin.

4. Nëse është përfshirë më shumë se një kontrollues ose përpunues, ose një kontrollues dhe një përpunues në të njëjtin përpunim dhe nëse ata, sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni, janë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga përpunimi, secili kontrollues ose përpunues mbahet përgjegjës për të gjithë dëmin me qëllim që të garantohet kompensim i efektshëm i subjektit të të dhënave.

5. Nëse një kontrollues ose përpunues, në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, ka paguar kompensim të plotë për dëmin e pësuar, ky kontrollues ose përpunues ka të drejtën të pretendojë nga kontrolluesit ose përpunuesit e tjerë të përfshirë në të njëjtin përpunim, atë pjesë të kompensimit që përputhet me pjesën e tyre të përgjegjësisë për dëmin, në pajtim me kushtet e parashikuara në paragrafin 2. të këtij neni.

6. Pala, për kompensim të dëmit, ka të drejtë të paraqesë padi pranë gjykatës kompetente.

KREU XIII
MBROJTJA INSTITUCIONALE E TË DHËNAVE PERSONALE AGJENCIA PËR INFORMIM
DHE PRIVATËSI

Neni 57
Statusi i Agjencisë

1. Agjencia është autoritet i pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe rregulloreve të tjera për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente dhe informacione publike.
2. Agjencia vepron me pavarësi të plotë në përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave, në pajtim me këtë ligj. Ajo i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.
3. Agjencia, në përmbushje të detyrave të saj dhe ushtrim të kompetencave të saj, vepron e lirë nga ndikimi i jashtëm, i drejtpërdrejtë ose jo, dhe nuk kërkon apo merr udhëzime nga askush.
4. Agjencisë i vihen në dispozicion burime njerëzore, financiare, teknike, mjedisore dhe infrastrukturore, të nevojshme për përmbushjen e efektshme të detyrave të saj dhe ushtrimin e kompetencave.

Neni 58
Organizimi i Agjencisë

1. Agjencia udhëhiqet nga Komisioneri.
2. Komisioneri përfaqëson Agjencinë, organizon dhe koordinon punën e saj.
3. Agjencia ka Drejtorin e Përgjithshëm, i cili kryen të gjitha detyrat e Zyrtaarit Kryesor Administrativ, në pajtim me legjislacionin përkatës.
4. Struktura organizative e Agjencisë përbëhet nga dy (2) fusha të veçanta profesionale për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Fushat e veçanta profesionale, të përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni, udhëhiqen dhe përbëhen nga shërbyes civilë, sipas këtij ligji dhe legjislacionit përkatës.
6. Zyrtarët e Agjencisë përmbahen nga çdo veprim që bie ndesh me detyrat e tyre dhe, gjatë mandatit të tyre, nuk angazhohen në profesione që bien ndesh me detyrat e tyre, qofshin me apo pa pagesë.
7. Në pajtim me ligjin përkatës në fuqi, Komisioneri nxjerr një akt nënligjor për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Agjencisë.
8. Zyrtarët e Agjencisë, në pajtim me këtë ligj, i nënshtrohen detyrës së fshehtësisë profesionale si gjatë mandatit ashtu edhe pas përfundimit të mandatit, në lidhje me çdo informatë konfidenciale që ata hasin gjatë kryerjes së detyrave apo ushtrimit të kompetencave të tyre.

Neni 59
Kriteret për përzgjedhjen e Komisionerit

1. Kandidatët për komisioner duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

- 1.2. Të kenë diplomë universitare në njërin nga këto fusha: juridik, administratë publike apo marrëdhënie ndërkombëtare;
- 1.3. Të kenë, së paku, tetë (8) vite përvojë pune profesionale, nga të cilat, së paku, pesë (5) vite përvojë në pozita udhëheqëse;
- 1.4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale apo të mos ketë pasur aktakuzë gjatë pesë (5) viteve të fundit.
- 1.5. Të kenë integritet të lartë moral dhe profesional;
- 1.6. Të kenë përvojë dhe njohuri të dalluara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- 1.7. Të mos jenë larguar nga puna ose shërbimi civil me masë disiplinore;
- 1.8. Të mos kenë ushtruar asnjë funksion në parti politike gjatë pesë (5) viteve të fundit. Nuk duhen të jenë deputetë të Kuvendit në Legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që i zgjedhin ata, apo të kenë qenë anëtarë të Kabinetit Qeveritar në mandatin e fundit.

Neni 60

Procedura e përzgjedhjes së Komisionerit

1. Komisioneri zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat shtesë.
2. Procedura për zgjedhje fillon me shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e Komisionerit, i cili publikohet në mediumet e shkruara dhe elektronike.
3. Në konkurs caktohen kriteret për përzgjedhjen e komisionerit, të parapara me këtë ligj. Afati i kohëzgjatjes së konkursit nuk mund të jetë më i shkurtë se pesëmbëdhjetë (15) e as më i gjatë se njëzetë (20) ditë.
4. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 3. të këtij neni, paneli përzgjedhës, i caktuar nga komisioni parlamentar për siguri i Kuvendit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur komisioner.
5. Paneli përzgjedhës zhvillon intervistë me secilin kandidat, i cili plotëson kushtet për t'u zgjedhur komisioner dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për votim nga Kuvendi i Kosovës.
6. Lista e ngushtë përmban tre (3) kandidatë, përveç në rastin kur brenda numrit tre (3), ka më shumë kandidatë me pikë të barabarta vlerësuese. Paneli përzgjedhës, listën e kandidatëve ia dorëzon komisionit, i cili, listën e ngushtë ia propozon Kuvendit të Kosovës. Propozimi i komisionit përmban arsyetimin përse paneli u ka dhënë përparësi disa kandidatëve, në krahasim me kandidatët tjerë.
7. Në rast të përfundimit të mandatit, Komisioneri ushtron funksionin e tij deri në zgjedhjen e komisionerit të ri.

Neni 61

Përfundimi i mandatit të Komisionerit

1. Mandati i Komisionerit përfundon në rastet kur:

- 1.1. përfundon mandatin e rregullt;
- 1.2. dorëheqjes;
- 1.3. vdekjes se tij/saj;
- 1.4. arrin moshën e pensionimit;
- 1.5. humbjes se përhershme të zotësisë së veprimit, të konstatuar nga gjykata kompetente;
- 1.6. behet i paaftë për arsye shëndetësore të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit për me shume se tre (3) muaj;
- 1.7. dënohet me vendim gjyqësor të formës për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg;
- 1.8. shkarkohet.

2. Kuvendi i Kosovës, me propozim të komisionit funksional për çështjet e sigurisë, me shumicën e votave të të gjithë deputeteve mund ta shkarkojë Komisionerin për shkak të arsyeve si në vijim:

- 2.1. për shkelje të dispozitave të këtij ligji;
- 2.2. në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij/saj.

Neni 62 **Financimi i Agjencisë**

1. Agjencia financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, dhe ka vijën e vet buxhetore e cila i garanton pavarësinë e saj.
2. Agjencia përgatit propozim-buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Buxheti i Agjencisë i nënshtrohet auditimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 63 **Paga e Komisionerit**

1. Niveli i pagës së Komisionerit, caktohet në pajtim me ligjin përkatës për pagat në sektorin publik.
2. Deri në hyrjen në fuqi të ligjit përkatës për pagat në sektorin publik, paga e Komisionerit është ekuivalente me pagën e deputetit të Kuvendit të Kosovës.

Neni 64 **Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë**

1. Pa cenuar detyrat e tjera të përcaktuara sipas këtij ligji, Agjencia kryen këto detyra:
 - 1.1. Mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji;
 - 1.2. Jep këshilla organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave;

- 1.3. Informon publikun për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave;
- 1.4. Promovon dhe përkrahë të drejtat themelore për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 1.5. Vendosë lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave;
- 1.6. Këshillon Parlamentin, Qeverinë, institucionet dhe organet e tjera të brendshme mbi masat legjislativë dhe administrative në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë për sa i takon përpunimit të të dhënave;
- 1.7. Kryen inspektime lidhur me zbatimin e këtij ligji;
- 1.8. Sipas rastit, kryen një rishikim periodik të certifikimeve të dhëna në pajtim me nenin 43 të këtij ligji dhe mund të tërheqë certifikimin, në rast se nuk plotësohen kriteret e certifikimit;
- 1.9. Me vetiniciativë ose me kërkesë, jep opinione për institucionet publike dhe organet tjera, si dhe publikon për çdo çështje lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 65

Bashkëpunimi me organet tjera

1. Agjencia bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian, lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në veçanti, Agjencia vendosë masa për bashkëpunim efektiv me autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera dhe organizatat ndërkombëtare, dhe siguron informacionin relevant dhe ndihmën e ndërsjellë, në përputhje me ligjin në fuqi. Ndihma e ndërsjellë mbulon, në veçanti, kërkesat për informacion dhe masa mbikëqyrëse, siç janë kërkesat për kryerjen e autorizimeve dhe konsultimeve, inspektimeve dhe hetimeve paraprake.
3. Agjencia merr të gjitha masat e duhura të kërkuara për t'iu përgjigjur kërkesës së një autoriteti tjetër mbikëqyrës pa vonesë të panevojshme dhe jo më vonë se një muaj pas marrjes së kërkesës. Masat e tilla mund të përfshijnë, në veçanti, transmetimin e informacionit përkatës për kryerjen e hetimeve.
4. Kërkesat për asistencë përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, duke përfshirë qëllimin dhe arsyet e kërkesës. Informacioni i shkëmbyer do të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është kërkuar.
5. Agjencia nuk refuzon përmbushjen e kërkesës, përveç nëse:
 - 5.1. nuk është kompetente për objektin e kërkesës ose për masat që kërkohet të ekzekutojë, ose;
 - 5.2. veprimi sipas kërkesës do të shkelte këtë ligj ose ligje të tjera të aplikueshme.
6. Agjencia informon autoritetin mbikëqyrës kërkuar për rezultatet ose, sipas rastit, për progresin e masave të marra për t'iu përgjigjur kërkesës. Agjencia jep arsyet për refuzimin e kërkesës në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni.
7. Agjencia, si rregull, e ofron informacionin e kërkuar nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse me mjete elektronike, duke përdorur një format të standardizuar.
8. Agjencia nuk kërkon asnjë pagesë për veprimet e ndërmarra prej tyre në bazë të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë në kushtet e reciprocitetit.

9. Agjencia, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me ligjin në fuqi, kryen operacione të përbashkëta duke përfshirë hetime të përbashkëta dhe masa të përbashkëta të zbatimit, ku përfshihen pjesëtarët ose stafi i autoriteteve mbikëqyrëse i shteteve të tjera ose organizatave ndërkombëtare.

Neni 66 **Raporti vjetor i punës**

1. Agjencia duhet t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës raport vjetor të punës dhe duhet ta publikojë atë, jo më vonë se më 31 mars të vitit vijues.

2. Raporti vjetor i aktiviteteve jep një pasqyrë të punës së Agjencisë dhe të zhvillimeve në fushën e qasjes në dokumente publike dhe mbrojtjes së të dhënave personale në vitin paraprak, dhe do të shkoqisë vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse.

Neni 67 **Publiciteti lidhur me punën**

1. Agjencia publikon në faqen e saj zyrtare ose në një mënyrë tjetër të duhur:

1.1. një gazetë të brendshme dhe literaturë profesionale;

1.2. çdo vendim të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në raste të tilla, të dhënat personale lidhur me palët, palët e dëmtuara, dëshmitarët ose ekspertët e përfshirë nuk publikohen;

1.3. opinionet rreth pajtueshmërisë së kodeve të etikës profesionale, kushteve të përgjithshme të biznesit ose draft-rregulloreve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

1.4. opinionet, sqarimet dhe qëndrimet për çështjet në fushën e mbrojtjes së të dhënave;

1.5. të gjitha udhëzimet dhe rekomandimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në fushat individuale;

1.6. deklaratat publike për inspektimet e ndërmarra për rastet individuale;

1.7. çdo njoftim tjetër të rëndësishëm.

KREU XIV **INSPEKTIMET DHE KONTROLLET**

Neni 68 **Fushëveprimi i inspektimeve**

1. Agjencia, sipas detyrës zyrtare apo në bazë të ankesës, mund të kryejë inspektime dhe kontrole, për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave. Në kuadër të kompetencave të inspektimit, Agjencia:

1.1. mbikëqyrë ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale;

1.2. mbikëqyrë përshtatshmërinë e procedurave dhe masave të ndërmarra për sigurinë e të dhënave personale në pajtim me këtë ligj;

1.3. mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji:

- 1.3.1. regjistrimin e aktiviteteve të përpunimit, sipas nenit 29 të këtij ligji;
- 1.3.2. njoftimin për shkeljen e të dhënave, sipas neneve 33 dhe 34 të këtij ligji;
- 1.3.3. vlerësimin e ndikimit të mbrojtjes së të dhënave, sipas neneve 35 dhe 36 të këtij ligji;
- 1.3.4. zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave, sipas nenit 37 deri 39 të këtij ligji;
- 1.3.5. kodet e sjelljes, sipas neneve 41 dhe 42 të këtij ligji;
- 1.3.6. mekanizmat e certifikimit, sipas nenit 43 të këtij ligji;
- 1.3.7. dhe regjistrimet e zbulimit të të dhënave të marrësit.

Neni 69

Zhvillimi i drejtpërdrejtë i inspektimit

1. Inspektimet dhe kontrollet kryhen drejtpërdrejt nga zyrtarët e inspektimit brenda kufijve të kompetencave të tyre;
2. Zyrtarët e inspektimit, gjatë kryerjes së inspektimit dhe kontrollit, duhet të identifikohen me kartelë zyrtare të identifikimit, e cila përmban: fotografinë, emrin personal, titullin profesional dhe të dhënat e tjera të nevojshme.
3. Me propozim të Komisionerit, Qeveria e Kosovës, nxjerr akt nënligjor, me të cilin përcaktohet mënyra e detajuar e formës dhe përmbajtjes së kartelës.

Neni 70

Përgjegjësitë e zyrtarëve të inspektimit

1. Gjatë kryerjes së inspektimit dhe kontrollit, zyrtarët e inspektimit kanë të drejtë të:
 - 1.1. kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin përkatës për klasifikimin e informacioneve, transferimin e të dhënave personale te shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe me zbulimin për marrësit e jashtëm;
 - 1.2. kontrollojnë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve në përputhje me legjislacionin përkatës për klasifikimin e informacioneve dhe katalogët e sistemit të dosjeve;
 - 1.3. kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion dhe udhëzim që rregullon sigurinë e të dhënave personale;
 - 1.4. kontrollojnë ndërtesën, në të cilën përpunohen të dhënat personale dhe kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik;
 - 1.5. verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim të sigurojnë të dhënat personale dhe zbatimin e tyre;
 - 1.6. kryejnë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve të parapara me këtë ligj.

Neni 71

Masat e inspektimit

1. Nëse zyrtari i inspektimit vë re shkelje të këtij ligji ose të cilitdo ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale, ai ose ajo ka të drejtë që:

1.1. të urdhërojë eliminimin e parregullsive ose mangësive që ai ose ajo i vë re, në mënyrën dhe brenda afatit të caktuar më parë nga ai ose ajo. Kjo mund të përfshijë asgjësimin, bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhënave personale në pajtim me ligjin;

1.2. të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit në sektorët publikë ose privatë, të cilët kanë dështuar në zbatimin e masave dhe procedurave të nevojshme për sigurimin e të dhënave personale;

1.3. të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale, anonimizimin e tyre, klasifikimin dhe bllokimin e të dhënave personale, sa herë që ai ose ajo konkludon se të dhënat personale janë duke u përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore;

1.4. të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale në vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, ose zbulimin e tyre marrësve të huaj, nëse ato janë transferuar ose zbuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore ose me marrëveshjet ndërkombëtare;

1.5. të urdhërojë kontrolluesin ose përpunuesin të përmbushë kërkesat e subjektit të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tij ose të saj në pajtim me këtë ligj;

1.6. të shqiptojë gjobë për shkeljet e këtij ligji;

1.7. të paralajmërojë ose këshillojë me shkrim kontrolluesin e të dhënave ose përpunuesin e të dhënave në rastet e shkeljeve të vogla.

2. Në rast të parregullsive ose mangësive, kontrolluesi i të dhënave ose përpunuesi i të dhënave duhet që menjëherë t'i korrigojë ato pas marrjes së udhëzimeve me shkrim ose këshillimit nga zyrtari i inspektimit, për të siguruar përpunim të ligjshëm të të dhënave.

3. Kundër vendimit përfundimtar të Agjencisë nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 72

Obligimi për të siguruar mbështetje

1. Organet publike dhe private janë të obliguara të ndihmojnë zyrtarët e inspektimit në përmbushjen e detyrave të tyre përmes:

1.1. sigurimit të informacionit, si përgjigje ndaj pyetjes së Agjencisë dhe lejin e inspektimit të dokumenteve dhe të të dhënave të dosjeve, në veçanti të të dhënave të ruajtura dhe të programeve për përpunimin e të dhënave, të cilat qëndrojnë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, dhe;

1.2. lejin e qasjes në objektet e tyre në çdo kohë.

KREU XV MARKETINGU I DREJTPËRDREJTË

Neni 73

Të drejtat dhe përgjegjësitë e kontrolluesve të të dhënave

1. Kontrolluesit e të dhënave mund të përdorin të dhënat personale që ata i kanë siguruar nga burimet publike të qasshme ose brenda kufijve të kryerjes së ligjshme të aktiviteteve për qëllime të ofrimit të mallrave, shërbimeve, punësimit ose kryerjes së përkohshme të punës përmes përdorimit të shërbimeve postare, thirrjeve telefonike, postës elektronike ose mënyrave të tjera të telekomunikimit (më tutje në tekst: marketingu i drejtpërdrejtë) në pajtim me dispozitat e këtij kreu, përveç nëse me ligjin përkatës është paraparë ndryshe.
2. Për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, kontrolluesit e të dhënave mund të përdorin vetëm të dhënat personale të grumbulluara në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni: emrin personal, adresën e vendbanimit të përhershëm ose të përkohshëm, numrin e telefonit, adresën e postës elektronike (e-mail). Në bazë të pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave, kontrolluesit e të dhënave mund të përpunojnë të dhëna të tjera personale, por të dhënat personale të ndjeshme mund t'i përpunojnë vetëm nëse ata e posedojnë pëlqimin me shkrim.
3. Kur kontrolluesit e të dhënave kryejnë marketing të drejtpërdrejtë, duhet t'i informojnë subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre sipas dispozitave të këtij ligji.
4. Nëse kontrolluesit e të dhënave kanë për qëllim të zbulojnë të dhëna personale nga paragrafi 2. i këtij neni, të marrësit e tjerë të të dhënave për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, ose tek përpunuesit e të dhënave, ata janë të detyruar që të informojnë subjektin e të dhënave dhe të marrin pëlqimin me shkrim të tij ose të saj para se të zbulohen të dhënat e tilla. Njoftimi për subjektin e të dhënave lidhur me zbulimin në fjalë duhet të përmbajë të gjitha informacionet që synohen të zbulohen si dhe kujt dhe për çfarë qëllimi. Shpenzimet e njoftimit mbulohen nga kontrolluesi i të dhënave.

Neni 74

E drejta për kundërshtim

1. Subjekti i të dhënave, në çdo kohë mund të kërkojë me shkrim që kontrolluesit e të dhënave të ndërpresin në mënyrë të përhershme ose të përkohshme përdorimin e të dhënave personale të tij ose të saj për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë. Brenda tetë (8) ditëve pas pranimit të kundërshtimit nga subjekti i të dhënave, kontrolluesit e të dhënave duhen të ndalojnë përdorimin e të dhënave personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë dhe brenda pesë (5) ditëve pasuese ata duhet të informojnë me shkrim subjektin e të dhënave për aprovimin e kërkesës së tyre.
2. Shpenzimet për veprimet e kontrolluesit të të dhënave në lidhje me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni i bartë kontrolluesi i të dhënave.

KREU XVI VËZHGIMI ME KAMERË

Neni 75

Dispozitat e përgjithshme

1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për vëzhgimin me kamerë, përveç kur është paraparë ndryshe me ligj përkatës.
2. Personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me

kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Organet publike ndërmarrin masat e përshtatshme për të identifikuar kontrolluesin. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'iu mundësojë subjekteve të të dhënave, që pa vështirësi, të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë.

3. Të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi me kamerë mund të përpunohen apo të shfrytëzohen, nëse është e nevojshme, për të arritur qëllimet e synuara dhe nëse nuk ekzistojnë indikacione të shkeljes së interesave legjitime të subjektit të të dhënave. Këto të dhëna mund të përpunohen apo të shfrytëzohen për qëllime të tjera, vetëm nëse janë të nevojshme për të parandaluar kërcënimet ndaj shtetit dhe sigurisë publike, apo për të ndjekur penalisht krimet.

4. Sistemi i vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet e vëzhgimit duhet të mbrohen në mënyrë të duhur nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar.

Neni 76

Vëzhgimi i ndërtesave zyrtare dhe të biznesit

1. Personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

2. Vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat.

3. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

4. Sistemet e vëzhgimit me kamerë mund të mbikëqyrin pjesën e jashtme dhe hyrjen e ndërtesës, por jo edhe hyrjen dhe brendinë e apartamenteve.

5. Personat që punojnë në ndërtesat publike dhe private nën vëzhgimin me kamerë informohen në mënyrë të duhur në formë të shkruar për instalimin e sistemeve të tilla dhe të drejtat e tyre.

6. Secili kontrollues i të dhënave duhet ta krijojë sistemin e dosjeve për regjistrimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë. Sistemi i dosjeve, veçmas nga regjistrimet (pamjet dhe/ose zëri), përmban datën, vendin, kohën e regjistrimit dhe se ku ruhen regjistrimet.

7. Regjistrimet nga paragrafi 6. i këtij neni mund të ruhen deri në (1) muaj, përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime.

Neni 77

Mbikëqyrja e ndërtesave me apartamente

1. Për instalimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë në ndërtesën me apartamente, kërkohet pajtimi me shkrim i së paku shtatëdhjetë për qind shtatëdhjetë për qind (70%) të pronarëve.

2. Vëzhgimi me kamerë mund të instalohet vetëm nëse kjo është e domosdoshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pronës.

3. Vëzhgimi me kamerë në ndërtesën me apartamente mund të mbikëqyrë vetëm hyrjen dhe hapësirat e përbashkëta. Ndalohet mbikëqyrja me kamerë e apartamentit të shtëpiakut të ndërtesës dhe punëtorisë së tij ose saj.

4. Ndalohet transmetimi i regjistrimeve të vëzhgimeve me kamerë përmes televizionit kabllor të brendshëm, televizionit publik kabllor, internetit ose mjeteve të tjera të telekomunikimeve, pa

marrë parasysht nëse bëhet në kohën e transmetimit apo më vonë.

5. Hyrjet në apartamentet individuale mund të mbikëqyren me sistem të vëzhgimit me kamerë vetëm nëse pronari vendosë kështu. Pronari mund t'i mbajë regjistrimet vetëm për nevoja të tij ose të saj.

Neni 78

Vëzhgimi me kamerë në sektorin e punësimit

1. Vëzhgimi me kamerë në hapësirat e punës mund të bëhet vetëm në rastet kur domosdoshmërisht kërkohet për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës dhe ruajtjen e informacioneve konfidenciale, nëse ky qëllim nuk mund të arrihet me mjete më të lehta.

2. Vëzhgimi me kamerë duhet të kufizohet rreptësisht në hapësirat ku janë të rrezikuara interesat nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Vëzhgimi me kamerë ndalohet në hapësirat jashtë vendit të punës, veçanërisht në dhoma të ndërrimit, ashensorë, hapësira sanitare dhe në hapësira pune me potencial të shkeljes së privatësisë së të punësuarve.

4. Para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë, punëdhënësi duhet t'i informojë me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Hapësirat e mbikëqyrura duhet të shënohen nga punëdhënësit përmes shenjave të përshtatshme.

5. Para fillimit të instalimit të sistemeve të vëzhgimit me kamerë në sektorët publik ose privat, punëdhënësi i informon përfaqësuesit e sindikatës, nëse është e zbatueshme.

6. Paragrafët 4. dhe 5. të këtij neni nuk zbatohen në hapësirat e mbrojtjes kombëtare, në aktivitetet e sigurisë shtetërore të zbulimit në vendet ku ruhen të dhënat sekrete.

Neni 79

Vëzhgimi me kamerë përmes dronëve

1. Të dhënat personale të marruar përmes dronëve përpunohen sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe me legjislacionin përkatës që rregullon çështjen e funksionimit të dronëve.

2. Agjencia, së bashku me Autoritetin e Aviacionit Civil, nxjerr akt nënligjor për mënyrën e përpunimit të të dhënave, të cilat merren nga përdorimi i dronëve.

KREU XVII

PËRDORIMI I KARAKTERISTIKAVE BIOMETRIKE

Neni 80

Përpunimi i karakteristikave biometrike

Përcaktimi dhe përdorimi i karakteristikave biometrike të subjektit të të dhënave dhe krahasimi i tyre për të mundësuar identifikimin e tij ose të saj rregullohet me dispozitat e këtij ligji.

Neni 81

Përdorimi i karakteristikave biometrike në sektorin publik

1. Sektori publik mund të përdorë karakteristikat biometrike, vetëm nëse domosdoshmërisht kërkohet për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe sekreteve të biznesit, nëse kjo nuk mund të arrihet me mjete më të lehta.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, përdorimi i karakteristikave biometrike mund të lejohet në pajtim me obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare detyruese ose për identifikimin e personave që kalojnë kufirin shtetëror.

Neni 82 **Kontrolli i qasjes**

Karakteristikat biometrike mund të përdoren në sektorin publik për arsyet e kontrollit të qasjes. Në këtë rast dispozitat e paragrafëve 2., 3. dhe 4. të nenit 84 të këtij ligji duhet të zbatohen përshtatshmërisht (*mutatis mutandis*).

Neni 83 **Përdorimi i karakteristikave biometrike në sektorin privat**

1. Sektori privat mund të përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve për sigurinë e njerëzve, për sigurimin e pronës ose për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale ose fshehtësive të biznesit. Të punësuarit duhet të informohen paraprakisht në formë të shkruar për përdorimin e karakteristikave të tyre biometrike rreth masave që merren dhe të drejtat e tyre.

2. Nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj përkatës, kontrolluesi i të dhënave duhet që para marrjes së masave për përdorimin e karakteristikave biometrike t'i ofrojë Agjencisë përshkrimin e detajuar për masat që do të merren, duke përfshirë informacionet që do t'i jepen subjektit të të dhënave, arsyet për marrjen e masave dhe masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Pas marrjes së informacionit nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia, brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të vendosë nëse informacioni i marrë lidhur me masat është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

4. Kontrolluesit e të dhënave mund të zbatojnë masat për përdorimin e karakteristikave biometrike, pas marrjes së autorizimit nga Agjencia.

5. Kundër vendimit nga paragrafi 3. i këtij neni nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

KREU XVIII **REGJISTRIMET E HYRJES DHE DALJES NGA NDËRTESTAT**

Neni 84 **Regjistrimi**

1. Organet e sektorit publik dhe privat, për arsye të garantimit të sigurisë së njerëzve dhe sigurimit të pronës, mund të kërkojnë nga personat që hyjnë ose dalin nga ndërtesat që t'u japin të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni. Nëse konsiderohet e domosdoshme, të dhënat personale mund të verifikohen duke i ekzaminuar dokumentet e identifikimit.

2. Të dhënat e regjistrimit të personave që hyjnë ose dalin nga ndërtesat mund të përmbajnë vetëm këto të dhëna personale: emrin personal, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit, adresën e përhershme ose të përkohshme, datën dhe kohën si dhe arsyen për hyrje në ndërtesë.

3. Të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohen si dokumente zyrtare, nëse grumbullimi i të dhënave kërkohet për qëllime të policisë dhe aktiviteteve të shërbimeve të inteligjencës.

4. Të dhënat personale nga regjistrimet, sipas paragrafit 2. të këtij neni, mund të ruhen deri në tri (3) vite nga dita e regjistrimit të tyre dhe pastaj duhet të fshihen ose shkatërrohen, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

KREU XIX LIBRAT PUBLIKË DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 85 Librat publikë

Të dhënat personale nga librat publikë, të rregulluara me ligjin përkatës, mund të përdoren vetëm në pajtim me qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose janë përpunuar, nëse qëllimi ligjor për grumbullimin ose përpunimin e tyre është përcaktuar ose është i përcaktueshëm.

KREU XX NDËRLIDHJA E SISTEMEVE TË DOSJEVE

Neni 86 Dokumentet zyrtare dhe librat publikë

1. Sistemet e dosjeve nga dokumentet zyrtare dhe librat publikë mund të bashkohen nëse kjo është e paraparë me ligj.
2. Kontrolluesi ose kontrolluesit e të dhënave që synojnë të ndërlidhin dy (2) ose më shumë sisteme të dosjeve që mbahen për qëllime të ndryshme, përpara se ta bëjnë këtë, duhet ta njoftojnë me shkrim Agjencinë.
3. Nëse, të paktën, njëri nga sistemet e dosjeve që ndërlidhen përmban të dhëna të ndjeshme ose nëse ndërlidhja do të rezultonte në zbulimin e të dhënave të ndjeshme, ose zbatimi i ndërlidhjes kërkon përdorim të kodit ndërlidhës, ndërlidhja nuk lejohet pa autorizimin paraprak të Agjencisë.
4. Agjencia mund të autorizojë ndërlidhjen, me vendim, sipas paragrafit 3. të këtij neni, nëse përcakton se kontrolluesi i të dhënave siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.
5. Kundër vendimit nga paragrafi 4. i këtij neni, nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 87 Ndalimi i ndërlidhjes së sistemeve të dosjeve

Ndalohet ndërlidhja e sistemeve të dosjeve penale dhe kundërvajtjeve me sistemet e dosjeve të tjera si dhe ndërlidhja e sistemeve në mes të dosjeve penale dhe atyre të kundërvajtjeve.

Neni 88 Ndarja e dokumenteve zyrtare dhe librave publikë

Të dhënat personale nga sistemet e dosjeve të dokumenteve zyrtare dhe librave publikë duhet të mbahen ndaras në regjistrin e sistemeve të dosjeve.

Neni 89 Të dhënat personale nga institucionet e mëparshme

1. Nëse, para 12 qershorit 1999, të dhënat personale janë ruajtur nga institucionet e mëparshme,

kryesisht për detyrat administrative të vetcaktuara, të cilat duhej të kryheshin nga autoritetet, institucionet dhe organet e tjera publike të shtetit, nga republikat socialiste, komunitetet, shoqatat e autoriteteve lokale, apo organet e tjera publike, të drejtën për këto të dhëna e kanë bartësit e administratës publike, përgjegjëse për detyrat administrative.

2. Institucionet e mëparshme, siç përkufizohet me paragrafin 1., të këtij neni, janë ish-organet e shtetit apo organet ekonomikisht aktive, kombinatet kolektive, operacionet apo objektet komerciale, si dhe organizatat shoqërore të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 90

Përpunimi i të dhënave personale nga institucionet e mëparshme

1. Përpunimi i të dhënave personale nga institucionet e mëparshme u lejohej organeve të cekura në nenin 89, paragrafi 1. të këtij ligji nëse:

- 1.1. njohja e këtyre të dhënave nevojitet për përmbushjen ligjore të ndonjë detyre, e cila është në kuadër të fushëveprimit të përgjegjësive të këtyre organeve;
- 1.2. mbledhja e përsëritur e këtyre të dhënave kërkon përpjekje joproportionale;
- 1.3. subjekti i të dhënave nuk e ka kundërshtuar përpunimin;
- 1.4. kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të përpunimit të të dhënave janë përcaktuar në mënyrë të qartë.
- 1.5. të dhënat personale, të cilat mund të përpunohen sipas nën-paragrafit 1.1. të këtij neni, konsiderohen sikur të jenë ruajtur paraprakisht për qëllimin e përcaktuar në përputhje me nenin 89, paragrafi 1. të këtij ligji.

KREU XXI

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 91

Kushte e përgjithshme për caktimin e gjobave administrative

1. Agjencia, për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, të cilët, gjatë përpunimit të të dhënave, shkelin dispozitat e këtij ligji, vendosë gjobë kundërvajtëse drejtpërdrejt, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- 1.1. natyrës, rëndësisë dhe kohëzgjatjes së shkeljes, duke marrë parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e përpunimit përkatës, si dhe numrin e subjekteve të të dhënave të prekura dhe nivelin e dëmit të pësuar prej tyre;
- 1.2. karakterit të qëllimshëm dhe mospërfillës të shkeljes;
- 1.3. çdo mase të marrë nga kontrolluesi ose përpunuesi për të lehtësuar dëmin e pësuar nga subjektet e të dhënave;
- 1.4. shkallës së përgjegjësisë së kontrolluesit ose përpunuesit, duke marrë parasysh masat teknike dhe organizative të zbatuara prej tyre në pajtim me nenet 24, 25 dhe 32 e 33 të këtij ligji;
- 1.5. çdo shkeljeje të mëparshme përkatëse nga kontrolluesi ose përpunuesi;
- 1.6. shkallës së bashkëpunimit me Agjencinë, me qëllim që të korrigohej shkelja dhe

për të zbutur efektet negative të mundshme të shkeljes;

1.7. kategorive të të dhënave personale të ndikuara nga shkelja;

1.8. mënyrës në të cilën shkelja erdhi në dijeni të Agjencisë, veçanërisht, nëse dhe në cilën masë kontrolluesi ose përpunuesi ka njoftuar për shkeljen;

1.9. nëse masat e referuara në kompetencat e Agjencisë janë urdhëruar më parë ndaj kontrolluesit ose përpunuesit përkatës në lidhje me të njëjtën çështje, respektimit të këtyre masave;

1.10. respektimi i kodeve të aprovuara të sjelljes dhe akteve tjera të brendshme.

1.11. çdo faktori tjetër rëndues ose lehtësues për rrethanat e çështjes, si përfitimet financiare të përfituara ose humbjeve të mënjanuara, drejtpërdrejt ose jo nga shkelja.

2. Nëse një kontrollues ose përpunues, në mënyrë të qëllimshme ose nga mospërfillja, për të njëjtat operacione ose të lidhura me to, shkel disa dispozita të këtij ligji, shuma totale e gjobës për kundërvajtje nuk kalon shumën maksimale të dyfishit të dënimit më të lartë me gjobë të përcaktuar me këtë ligj.

Neni 92

Shkeljet e përgjithshme të dispozitave të këtij ligji

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzetë mijë (20,000€) deri në dyzet mijë (40,000€), nëse:

1.1. përpunon të dhëna personale pa bazë ligjore ose pëlqim personal të subjektit të të dhënave sipas këtij ligji;

1.2. ia beson një detyrë individuale që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale një personi tjetër pa lidhur kontratë me shkrim në pajtim me paragrafin 2. të nenit 32 të këtij ligji;

1.3. përpunon të dhëna personale të ndjeshme, të veçanta, në kundërshtim me nenin 6, nenin 8. të këtij ligji, ose nuk i mbron ato në pajtim me nenin 7. të këtij ligji, paragrafin 4 të nenit 8 të këtij ligji.

1.4. përpunon të dhënat personale në kundërshtim me nenet 10 dhe 12 të këtij ligji;

1.5. grumbullon të dhënat personale për qëllime që nuk janë të definuara në mënyrë të qartë dhe të paligjshme, ose nëse vazhdon t'i përpunojë ato në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji;

1.6. e pajisë marrësin e të dhënave me të dhëna personale në kundërshtim me paragrafin 3. të nenit 8 të këtij ligji;

1.7. nuk informon subjektin e të dhënave për përpunimin e të dhënave personale në pajtim me nenet 10 dhe 12 të këtij ligji;

1.8. përdorë kodin e njëjtë lidhës në kundërshtim me paragrafin 3. të nenit 86 të këtij ligji;

1.9. nuk i asgjëson, shkatërron, bllokon ose nuk i bën anonime të dhënat personale atëherë kur qëllimi për të cilin janë mbledhur dhe/ose përpunuar është arritur në pajtim me paragrafin 5. të nenit 4 të këtij ligji;

1.10. dështon të sigurojë se katalogu i sistemit të dosjeve përmban informacione të garantuara me nenin 29 të këtij ligji;

1.11. dështon të njoftojë Agjencinë për informacionet lidhur me regjistrin e sistemeve të dosjeve, sipas nenit 30 të këtij ligji;

1.12. vepron në kundërshtim me nenin 14 të këtij ligji;

1.13. vepron në kundërshtim me nenet 46 dhe 49 të këtij ligji dhe transferon të dhënat personale te vendet e tjera apo organizatat ndërkombëtare.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dy mijë (2,000) € deri në katër mijë (4,000) €, për shkeljet nga nën-paragrafi 1.13., paragrafit 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individu dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërqind (400) deri në një mijë (1,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 93

Shkelja e dispozitave për përpunimin kontraktues

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur, dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëzetë mijë (20,000) deri në dyzet mijë (40,000) €, nëse tejkalon autorizimin e shprehur në kontratë nga paragrafi 2. i nenit 32 të këtij ligji ose nuk i kthen të dhënat personale në pajtim me paragrafin 4. të nenit 32 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në katër mijë (4,000) € për shkeljet nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individu dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 94

Shkelja e dispozitave për sigurinë e të dhënave personale

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetë mijë (8,000) deri në dyzet mijë (40,000) €, nëse gjatë përpunimit të të dhënave personale dështon të garantojë nivel të duhur për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas nenit 31 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personit që ushtron veprimtari të pavarur, dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në katër mijë (4,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në tetë mijë (8,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individu dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 95**Shkelja e dispozitave për marketingun e drejtpërdrejtë**

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katër mijë (4,000) deri në dhjetë mijë (10,000) €, nëse në pajtim me këtë ligj përpunon të dhënat personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë dhe nuk vepron në pajtim me nenet 73 ose 74 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tetëqind (800) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Individidi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërqind (400) deri në një mijë (1,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 96**Shkelja e dispozitave të përgjithshme për vëzhgimin me kamerë**

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur, dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katër mijë (4,000) deri në dhjetë mijë (10,000) € nëse:
 - 1.1. nuk publikon njoftimin në mënyrën e paraparë në paragrafin 2. të nenit 75 të këtij ligji;
 - 1.2. njoftimi nuk përmban informacionet e domosdoshme nga paragrafi 3. i nenit 75 të këtij ligji;
 - 1.3. nuk mbron sistemin e vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet që përdoren për të kryer vëzhgimin me kamerë në kundërshtim me paragrafin 4. të nenit 76 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.
4. Individidi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 97**Shkelja e dispozitave për vëzhgimin me kamerë lidhur me qasjen në ndërtesat zyrtare dhe të biznesit**

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur, dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katër mijë (4,000) deri në dhjetë mijë (10,000) €, nëse:
 - 1.1. i zbaton sistemet e vëzhgimit me kamerë pa një vendim të nevojshëm me shkrim ose pa ndonjë bazë ligjore nga neni 76 i këtij ligji;
 - 1.2. i zbaton sistemet e vëzhgimit me kamerë me qëllim të vëzhgimit të brendësisë së ndërtesave në kundërshtim me paragrafin 4. të nenit 76;
 - 1.3. nuk ka informuar të punësuarit me shkrim nga paragrafi 5. i nenit 76;

1.4 ruan të dhënat personale në kundërshtim me paragrafin 7. të nenit 76 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individit dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 98

Shkelja e dispozitave për vëzhgimin me kamerë në ndërtesat me apartamente

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katër mijë (4,000) deri në dymbëdhjetë mijë (12,000) € nëse zbaton sistemet për vëzhgimin me kamerë në kundërshtim me nenin 77 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërqind (400) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individit dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në katërqind (400) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 99

Shkelja e dispozitave për vëzhgimin me kamerë në hapësirat e punës

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet me gjobë prej tetë mijë (8,000) deri në dyzet mijë (40,000) € nëse zbaton sistemet e vëzhgimit me kamerë në hapësirat e punës në kundërshtim me nenin 78 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dy mijë (2,000) deri në katër mijë (4,000) € nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në dy mijë (2,000) € nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individit dënohet me gjobë prej tetëqind (800) deri në një mijë (1,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 100

Shkelja e dispozitave për karakteristikat biometrike në sektorin publik

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetë mijë (8,000) deri në dyzet mijë (40,000) € nëse zbaton masat biometrike në kundërshtim me nenin 81 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dy mijë (2,000) deri në katër mijë (4,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet me gjobë prej një mijë (1,000) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 101

Shkelja e dispozitave për karakteristikat biometrike në sektorin privat

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetë mijë (8,000) deri në dyzet mijë (40,000) € nëse zbaton masat biometrike në kundërshtim me nenin 83 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dy mijë (2,000) deri në katër mijë (4,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 102

Shkelja e dispozitave për regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katër mijë (4,000) deri në tetë mijë (8,000) €:

1.1. nëse shfrytëzon regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa si dokumente zyrtare në kundërshtim me paragrafin 3. të nenit 85 të këtij ligji;

1.2. nëse vepron në kundërshtim me paragrafin 4. të nenit 84 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individu dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 103

Shkelja e dispozitave për ndërlidhjen e sistemeve të dosjeve

1. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në pesë mijë (5,000) €, i cili ndërlidhë sistemet e dosjeve në kundërshtim me nenin 87 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri në dy mijë (2,000) €, nëse ndërlidhë sistemet e dosjeve nga evidenca penale ose evidencat e kundërvajtjeve me sistemet e dosjeve të tjera, ose ndërlidhë sistemet e dosjeve nga evidencat penale me sistemin e dosjeve nga evidenca e kundërvajtjeve sipas nenit 87 të këtij ligji.

Neni 104

Shkelja e dispozitave për mbikëqyrjen nga personi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

1. Personi juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetë mijë (8,000) në dyzet mijë (40,000)€:

1.1. nëse kryen kontrollin në kundërshtim me nenin 39 të këtij ligji;

1.2. nëse nuk mbanë një shënim ose regjistrime të tjera sipas nenit 39 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1,000) deri në dy mijë (2,000) € për shkelje nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. Individu dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri një mijë (1,000) € për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 105

Shkeljet e rënda dhe në masë të madhe të dispozitave ligjore

Në rast se Agjencia konstaton se ka shkelje të rëndë dhe në masë të gjerë të të dhënave personale, mund të vendosë gjobë nga njëzet mijë (20,000) € deri në dyzet mijë (40,000) €, ose në rastin e një kompanie apo ndërmarrjeje, mund të vendosë gjobë 2% deri 4% të qarkullimit të përgjithshëm vjetor të vitit financiar paraprak në përputhje me Rregulloren (EU) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë, për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave.

Neni 106

Përgjegjësitë tjera

Shqiptimi i dispozitave ndëshkuese, sipas këtij ligji, nuk përjashton përgjegjësitë tjera në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, në veçanti përgjegjësinë e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave për dëmet që rrjedhin nga përpunimi i paligjshëm dhe përgjegjësia penale siç përcaktohet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 107

Tarifat

Tarifat për njoftimet dhe autorizimet, sipas këtij ligji, rregullohen me akt nënligjor nga Agjencia.

KREU XXII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 108

Bartja e aseteve, të drejtave dhe detyrimeve, buxhetit dhe personelit

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha asetet fizike, te drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat e lidhura, dhe ndarjet buxhetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i barten Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, personeli i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i bartet Agjencisë për Informim dhe Privatësi, së bashku me pozitat e tyre të mbajtura, sipas akt-emërimeve, vendimeve dhe kontratave të punës.

3. Agjencia për Informim dhe Privatësi brenda tre (3) muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i zyrtarizon obligimet kontraktuese me personelin e bartur, duke lëshuar akt-emërimet e reja, sipas këtij ligji dhe legjislacionit përkatës.

Neni 109
Aktet nënligjore

1. Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj nxirren në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja e tij në fuqi.
2. Aktet nënligjore që janë në fuqi vazhdojnë të zbatohen, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 110
Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-172, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 111
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L-082
30 janar 2019

Shpallur me dekretin Nr. DL-59-2019, datë 14.02.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi